

RREGULLORIA E SHFRYTËZIMIT TEKNIK TE HEKURUDHAVE (RSHT)

P J E S A E P A R E

Kapitulli I

NDERTIMET DHE PAISJET HEKURUDHORE

Dispozita te Pergjitheshme

Neni 1

Per nje shfrytezim normal hekurudhat duhet te kene.

- a. Vijen hekurudhore dhe vijat e tjera ndihmese te cilat sherbejne per kalimin, kryqezimin, formimin dhe shformimin e trenave.
- b. Ndertimet per hipjen, zbritjen dhe sherbimin e udhetareve.
- c. Vijat hekurudhore, sheshet, depot dhe ndertimet e tjera teknologjike per ruajtjen, shkarkimin dhe ngarkimin e mallrave.
- ç. Paisjet dhe instalimet e nderlidhjes, te sinjalizimit dhe te sigurimit teknik te levizjes se trenave.
- d. Vendet e punes per kryerjen e riparimeve dhe te sherbimeve te mjeteve hekurudhore, paisjet per furnizimin e tyre me lende djegese, lubrifikante dhe me uje, si dhe pasijet per furnizimn me energji elektrike.

Neni 2

Te gjitha vendet e punes te paisjeve hekurudhore duhet te mbahen ne gjendje te mire pune. Detyrat kryesore te punonjesve qe pergjigjen per funksionimin dhe mirmbajtjen e ndertimeve dhe te paisjeve, eshte te sigurojne pune normale te tyre, si dhe te menjanojne difektet qe ndodhin ne to.

Rregulla te dorezimit dhe te marjes ne shfrytezim te ndertimeve, te paisjeve dhe te instalimve hekurudhore

Neni 3

Sipas urdherit te ministrit nr.885/1 date 31.03.1988 neni 3 te RSHT biqet pjesa “ dhe e miraton ministria e transporteve”

Perberja e komisionit te marjes ne dorezim caktohet

- a. Per vijat hekurudhore te reja kryesore, ndertimet dhe degezimet – nga ministra e komunikacioneve.
- b. Per degezimet dhe vijat e reja te ndertuara ne stacionet hekurudhore – nga drejtoria e hekurudhes. Drejtorja e hekurudhes ne baze te aktkontrollit te mbajtur nga komisioni perkates, nxjerr vendimin per venien ne shfrytezim te ketyre vijave te reja, pasi te jene plotesuar kushtet e novojeshme per shfrytezim te sigurt dhe normal.

Neni 4

Ndertimet, mjetet mekanizmat dhe paisjet hekurudhore duhet tu pergjigjen me perpikmeri projekteve te miratuara dhe kushteve teknike.

Ndalohej te behen ndryshime ne konstruksionet e vijave, degezimeve, ndertimeve, mjeteve dhe paisjeve hekurudhore pa miratimin e organit perkates.

Permasat

Neni 5

Permasa e afrimit te ndertimeve quhet vija kufizuese qe cakton largesine e lejuar tew ndertimeve, te paisjeve dhe te mekanizmave nga boshti i vijes hekurudhore dhe nga siperfaqja e siperme e kokes se shines.

Permasa e afrimit e lejuar eshte jo me pak se 2.500 mm nga boshti ne vijen kryesore dhe jo me pak se 2.000 mm ne vijat e stacioneve.

Permasat e stacioneve duhet te jene ne keto vlera.

- a. Gjersi jo me e vogel se 4.700 mm
- b. Lartersi jo me e vogel se 5.500 mm nga koka e shines.

Neni 6

Permase e mjeteve hekurudhore quhet vija kufizuese, jashte se ciles nuk mund te dale asnje pjese e mjeteve , qofshin keto plot apo bosh:

- a) Ne gjeresi jo me shume se 1.500 mm nga aksi i vijes hekurudhore.
- b) Ne lartesi jo me teper se 4.650 mm nga koka e shines.

Neni 7

Largesia ndermjet boshteve te vijave, kur jane te dyfishta ne vije te drejte nuk duhet te jene me pak se 4.000 mm. Ne kthese kjo largesi zmadhohet ne varesi te rrezes se ktheses. Lagesia ndermjet boshteve te vijave hekurudhore ne stacion nuk duhet te jete me pak se 5.000 mm. Ne vijat e dyta (jo kryesore) te shesheve te mallrave kjo largesi mund te arrije deri ne 4.700mm.

Neni 8

Largesia nga boshti i vijes deri ne shteg nuk duhet te jete me pak se 2.000mm. Ne vijat ku vendosen ujemarres, largesia ndermjet boshteve te vijave kufizuese duhet te jete jo me pak se 4.750 mm, kurse nga boshti i vijes, deri ne faqen e shtylles se shenjdhesisit dhe te shenjes se manovravres, nuk duhet te jete me e vogel se 2.200 mm.

Largesia nga boshti i vijes e deri te faqja e peronit duhet te jete 1.250 mm (+, - 20mm), ndersa lartesia e peronit duhet te jete 380 mm(+, - 20 mm) nga koka e shines.

Neni 9

Per mosrespektimin e permasave mbajne pergjegjesi

- a. Tekniku u vijes hekurudhore, per permasat e afrimit te ndertimeve
- b. Dispeceri operativ, magazinieri dhe spontatori per vendosjen e mallarave ne sheshe, nagazina dhe mjete hekurudhore.
- c. Pergjegjesi i qendres se punes dhe punonjesite tjere qe lidhen me sigurimin e perpasses se nevojeshme ne degezimet hekurudhore.

Kapitulli II

VIJA HEKURUDHORE Dispozita te Pergjithshme

Neni 10

Vija hekurudhore perbehet prej tabanit, veprave te artit dhe shtreses se siperme te tyre. Anes vijes vendosen treguesit, shenjat dhe ndertohen kabinat per punetoret e sherbimit. Te gjitha perberesit e vijes hekurudhore duhet te jene te qendrueshem dhe ne gjendje qe te sigurojne levizjen pa rrezik te trenave me shpejtesi maksimale te percaktuar ne grafikun e levizjes.

Planimetria dhe profile i vijes hekurudhore

Neni 11

Vija hekurudhore, persa i perket rrezeve te kthesave, gjeresise, pjerrise etj.. duhet ti pergjigjet planimetrise dhe profilit te miratuar. Ne vijen hekurudhore me pjerrresi mbi 6 % vendosen kunderrreshqitesit, te cilet duhen te jene ne kontroll te vazhdueshem te rojes se shines, brigadierit dhe teknikut te vijes, ne menyre qe te funksionojne ne rregull.

Neni 12

Stacionet, si rregull vendosen ne vende te sheshta dhe te drejta. Ne raste te vecanta lejohet vendosja e tyre ne pjerresi por jo me te madhe se 1.5 permije. Vendet e qendrimit per hipjen dhe zbritjen e udhetareve mund te vendosen ne pjerresi jo me te madhe se 6 permije.

Neni 13

Kur shihet e domosdoshme qe stacionet e kryqezimit te vendosen ne kthese, rrezja e tyre duhet te jete jo me pak se 600 m dhe ne kushte malore jo me pak se 500 m.

Neni 14

Kontrrolli me aparat i boshtit te vijes hekurudhore behet te **pakten nje here ne 10** vjet nga Drejtoria e Hekurudhes.

Tabani Tokesor

Neni 15

Tabani i tokes perben nje nga elementet kryesore te vijes hekurudhore. Nga gjendja dhe ruajtja e formes se tij varet gjendja e rregullt e te gjithe vijes hekurudhore.

Neni 16

Karakteristikat teknike te tabanit duhet tu pergjigjen plotesisht atyre te miratuara ne projektet perkatese.

Neni 17

Gjeresia e tabanit tokesor ne pjesen e sipërme, ne vije te drejte duhet te jete jo me e vogel se 5.5 m per vije njefishe dhe jo me e vogel se 10 m per vijen dyshe, ndersa ne toke shkembore duhet te jete perkatesisht jo me pak se 4.2 m dhe 8.2 m.

Neni 18

Tabani tokesor duhet te mbrohet nga rrjedhja e ujerave me ndertime te tjera si prita, kanale kullues, kuneta parakalime etj. Ne vendet ku ka vershime dhe grumbullime ujerash, duhet te shenohet niveli maksimal i vales. Baza e tabanit tokesor ne keto raste duhet te jete 0.5m me e lartte se niveli i vales se ujit.

Veprat e artit

Neni 19

Veprat e artit sherbejne per shtrirjen e vijes hekurudhore mbi lumenjte, perrenjte, ne vendet ku ka keneta dhe ne nivele te uleta. Te ketilla jane urat, tunelet, tubinat dhe viaduktet. Veprat e artit duhet te kontrollohen, ne menyre te vecante per te ruajtur nga veprimet e demshme atmosferike. Te gjitha veprat e artit duhet te jene nen **kontrollin teknikeve te vijes hekurudhore** brigadierëve dhe rojtareve te shines. Tekniku i vijes hekurudhore njehere **ne muaj regjistrion** ne nje liber te posacem kontrollin e imet qe behet mbi cdo veper arti. Drejtoria e hekurudhes cakton se cilat vepra arti duhen ruajtur ne menyre te vecante.

Shtresa e sipërme

Neni 20

Shtrese e sipërme e vijes hekurudhore **quhet konstruksioni qe ndodhet mbi tabanin tokesor**. Ajo perfshin ballastin, shinat dhe paisjet e tyre, nderrueset dhe kunderreshqitjet e shianve. Keto perberese duhet te plotesojne kerkesat e standarteve ne fuqi ose te kushteve teknike te miratuara.

Neni 21

Gjeresia e vijes hekurudhore (largesia ndermjet faqeve te brendeshme te shinave) e matur 14mm poshte sipërfaqes se kokes se shines duhet te jete

- a. Ne vije te drejte 1.435 mm me nje tolerance ne zgjerim 10 mm dhe ne ngushtim 3mm
- b. Ne kthese me rreze me te vogel por jo me teper see 25 mm

Gjeresia e vijes hekurudhore nuk duhet te jete me e vogel se 1.432 mm ne vije te drejte dhe jo me e madhe se 1.460 mm ne kthese

Neni 22

Sipërfaqja e sipërme e kokes se shinave paralele te vijes hekurudhore ne vije te drejte duhet te jete ne nje nivel. **Lejohet nje disnivel deri ne 5 mm**

Ne kthese disnivele ndermjet shines se brendeshme dhe asaj te jashteme vendoset ne varesi te rrezes dhe te shpejtesise maksimale te levizsjes, por lartesia maksimale nuk duhet te kaloje 125mm

Ballasti

Neni 23

Ballasti eshte nje nga perberresit kryesore te shteses se sipërme te vijes hekurudhore. Per kete qellim mund te sherbeje cakelli, zhavorri, rera te cilat perdoren sipas normativave te miratuara te projektit te hekurudhave.

Ballasti kryen keto funksione.

a. Shperndan ne menyre te barabarte ngerkenen e trenit ne nje sipërfaqe sa me te madhe ne tabanin tokessor.

b. Kullon ne menyre te rregullt ujin

c. Nuk lejon zhvendosjen e traversave ne drejtim gjatesor dhe terthor.

Traversat

Neni 24

Traversat qe perdoren ne ndertimin e hekurudhave te reja ose ato qe sherbejne ne hekurudhat eksistuese, **nga cilesia dhe permasat duhet te plotesojne kerkesat e standarteve shteterore.**

Traversat e drurit dhe te betonit ne pjesen e mbeshtetjes se pllakes shtruese duhet te jene te rrafshuara mire, ne menyre qe te perballojne ngarkesen e trenit, mberthimin e gozhdeve, te bullonave ose te vidhave te traversave.

Shinat

Neni 25

Sipas urdberit te ministrit nr885/1 date 31.03.1988. neni 25 RSHT biqet komplet.

Neni 26

Shinat kontrollohen rregullisht me defektoskop nje here ne 6 muaj.

Kundershinat

Neni 27

Per te pasur nje siguri me te plote ne vijat hekurudhore, kundershinat vendosen.

a. Ne urat me gjatesi me te madhe se 30 m ne te dy anet

b. Ne zonat ku traseja eshte ndertuar me mur te larte vendosen vetem ne njeran ane (nga ana e kundert e murit) ne te gjitha gjatesine e tij.

c. Ne zonat e trasese se dobet, kur verehen ulje ose rreshqitje te saj gjate shfrytezimit.

d. Ne perforcimin e kthesave, kur shihet e novojeshe teknike

Ne te gjitha rastet e mesiperme kundershinat vendosen 20 mm larg shinave, e matur kjo ndermjet faqeve te brendeshme te kokes se shinen

Kundershinat mberthehen me pllaka shtruese me nga 2 gozhda ose vidha per cdo traverse dhe lidhen me pllaka lidhese, te paketen me nga 2 bullona.

Ne kalesat hekurudhore kundershiant vendosen nga te 2 anet e shianev ne nje largesi 70-75 mm, prej faqeve te kokes se shines.

Ne kthesat me rreze me te vogel se 500 m kjo hapesire rritet deri ne 95 mm sipas madhesis se rrezes. Ne te gjitha kalesat kundershiant vendosen mbi pllaka shtruese te mberthyera me nga 3 gozhde ose me 3 vidha ne traverse.

Neni 28

Pergjegjësia per moszbatimin e rregullave te sipertreguara bie mbi teknikun dhe brigadierin e vijes hekurudhore.

Nderrueset

Neni 29

Nderrueset sherbejne per kalimin e mjeteve hekurudhore nga njera vije ne tjetren. Ata duhet tu pergjigjen vizatimeve te miratuara, si dhe tipave te shinave te vendosura ne vije.

Neni 30

Ne vijat hekurudhore kryesore te pranim nisjes se trenave nderreset duhet te jene ne kend shmangieje **jo me te vogel se 1:9**. Ne vijat anesore mund te perdoren nderruese me kend shmangieje me te madh.

Neni 31

Nderrueset duhet te kontrollohen vazhdimisht me meter ose me shabllon dhe te nivelohen ne rregull, duke ruajtur me saktësi permasat e lejuara te pjeseve te tyre.

Neni 32

Ndalohet te mbahen ne vijen hekurudhore nderrueset qe kane qofte edhe nje nga keto te meta.

a. Kur gjilpera eshte larguar nga shina baze me shume se 4mm

b. Kur gjilpera eshte ulur perkundrejt shines baze me shume se 2 mm, e matur kjo ne seksionin ku nga siper ajo te jete e gjere 50 mm e me shume, per nderrueset pa kllapa, lartesimi i gjilperes kundrejt shines lejohet deri ne 1 mm, e matur kjo ne kete seksion.

c. Kur konsumi vertikal i shines bazae eshte me shume se 8 mm ne vijen kryesore dhe 10 mm ne vijat e tjera te stacionit.

ç. Kur gjilpera eshte ciflosur ne gjatesi me shume se 200 mm ne viajt kryesore dhe 400 mm ne viajt e tjera, si dhe kur eshte konsumuar amaja e gjilperes ne gjersine 20 mm te saj me shume se 8 mm

d. Kur konsumi vertikal i zemres ne seksionin me trashesi 40mm eshte me teper se 8 mm oer vijat kryesore dhe me tepr se 10mm ne vijat e tjera te stacionit.

dh. Kur eshte thyer gjilpera ose shina baze.

e. Kur eshte thyer zemra e degezimeve ose e berthames.

f. Kur jane keputur dy ose me shume bulona te kundershines.

g. Kur mungojne gozhdat apo bulonat etj.

Neni 33

Permasat karakteristike te nderruesve dhe vlerat e konsumit percaktohen ne rregulloren e mirembajtjes se vijave hekurudhore.

Hegja dhe vendosja e nderruesve neper stacione behet vetem me urdher te kryetarit te deges se vijave hekurudhore ne drejtorine e hekurudhes.

Neni 34

Vendosja e nderruesve ne vijen hekurudhore kryesore behet ne raste te jashtezakoneshme dhe vetem me urdher te ministrit te komunikacioneve.

Neni 35

Te gjitha nderrueset duhet te jene te paisur me shenja te dukshme ditën dhe natën. Nderrueset qe vendosen per here te pare, ose nderruesve qe u behet riparimi si ne stacione, ashtu dhe ne vijen hekurudhore, u jepen ne dorezim me procesverbale punonjesve te levizjes nga tekniku I vijes hekurudhore.

Neni 36

Nderrueset qe ndodhen ne parkun e lokomotivave e vagonave, ne ofcinat e riparimit ose ne degezime hekurudhore ne administrim te ndermarjeve, jane be varesi te pergjegjesve perkates, te cilet pergjigjen per organizimin e pastrimit, sigurimit, ndricimit dhe mirembajtjes se tyre. Te gjitha llojet e riparimeve dhe te mirembajtjes se zakoneshme te nderruesve behen nga sektori I mirembajtjes, ndersa riparimi I shenjave dhe I paisjeve te sigurimit behen nga personat e sektorit te shenjezimit dhe te sigurimit te levizjes se trenave.

Neni 37

Pergjegjesi I departamentit ose shefi I stacionit pergjigjet per organizimin e mirembajtjes per gjendjen dhe gadishmerine teknike te vijave hekurudhore, te nderruesve dhe te veprave te artit, si dhe per gjendjen e mjeteve dhe te paisjeve te sigurimit teknik te levizjes se trenave.

Treguesit dhe shenjat e vijave hekurudhore

Neni 38

Gjate vijes hekurudhore vendosen treguesit e perhereshem te meposhtem

- a. Guret e hektometrazhit dhe te kilometrazhit
- b. Fillimet, meset dhe mbarimet e kthesave
- c. Treguesit e shpjetesise sipas gjatesise
- ç Shtegu I levizjes se vijes hekurudhore
- d. Treguesit e fillimit dhe mbarimit te sektoreve te brigadave]

Pervec treguesve te perhereshem ne vijen hekurudhore vendosen edhe tregues te perkoheshem per kufizimin e vendeve te punimeve, per lajmerimin e rreziqeve etj.

Neni 39

Treguesit e vijes hekurudhore vendosen ne krahun e djathte te saj, ne drejtim te rritjes se kilometrazhit ne largesine jo me te vogel se 2 m nga shina me e afert.

Neni 40

Treguesit, lartesia e te cilave nuk kalon lartesine e kokes se binarit, mund te vendosen ne largesi jo me te afert se 1.3 m nga binari

Gjate vijes hekurudhore vendosen edhe keto shenja.

- a. Shenjat e kufizimit te shpjetesise, dhenjedhenesit dhe parashenjat.
- b. Shenjat e kujdesise
- c. Tabelat qe tregojne fundin e stacionit

- ç. Shenjat qe vendosen ne nderrueset dhe ne vendet ku bashkohen vijat hekurudhore.
- d. Tabelat e kufirit te manovres.

Neni 41

Te gjithë treguesit dhe shenjat e vijave hekurudhore duhet te jene te standartizuara sipas percaktimeve te rregullores se shenjezimit.

Kalesat hekurudhore

VO. Neni 42, 43, 44 shfuqizohen komplet. Nr prot. 5040 dt. 04/10/1988

Karakteristikat teknike te kalesave hekurudhore

Neni 45

1. Kendi I nderprerjes se vijes hekurudhore me rrugen duhet te jete me I madh se 45 grade
2. Gjeresia e kaleses hekurudhore duhet te jete e barabarte me gjeresine mesatare te rruges.
3. Ne nje largesi deri 10 m nga te dy anet e mesit te kaleses rruga duhet te jete horizontale ne nivelin e kokes se shines.Me tej pjerrësia e rruges mund te jete deri 5%

Dispozita te pergjitheshme

Neni 46

1. Kalesat hekurudhore i cakton Drejtoria e pergjitheshme e hekurudhave duke zbatuar kushtet e mesiperme.
2. Ruajtjen mirembajtjen dhe perdorimin e kaleses se ruajtur hekurudhore e ka per detyre roja e kaleses. Drejtoria rajonale apo stacioni hekurudhorpergjigjet per gjendjen teknike dhe funksionale te te gjitha kalesave qe kane ne varesi.
3. Kalesat e ruajtura ruhen 24 ore.
4. Pozicioni normal i kaleses se ruajtur eshte me krahe te hapur. Krahet mbyllen prej rojes se kaleses kur merret urdheri nga inspektori i sherbimit qe e ka ate ne varesi dhe 2 minuta para kalimit te trenit ne kalese. Llogaritja e kohes se mbylles do te behet sipas shpejtesise maksimale te lejuar te levizjes se trenave te mallrave dhe te udhetareve. Keto llogaritje ne forme tabele vendosen ne cdo kalese te ruajtur prej stacionit apo drejtorise qe e ka ate ne varesi.

Neni 47

1. Kalimi i automjeteve karrove, kembesoreve mbi vijen hekurudhore ne vende te pacaktuara per kete qellim nuk lejohet. Mbikqyrjen e kane per detyre rojet e shines, punetoret e mirembajtjes se vijes dhe punonjes te tjere te hekurudhes.
2. Drejtoria e hekurudhes cakton kalesat per kalimin e mjeteve te renda me zinxhir duke mare masa per forcimin e tabanit tokesor te kaleses.

Neni 48

Brigadat e sherbimit te viejs hekurudhore dhe te shenjezimit mirmbajne te gjithë vijen hekurudhore, paisjet dhe shenjat e saj sipas sektoreve te caktuar.
Punimet per rikonstruksionin e mesem dhe kapital te vijes hekurudhore, si dhe punimet e tjera me karkater te madh, kryhen nga brigadat e mermetimeve.

Organizimi i kontrollit ne mirembajten dhe ruajtjen e vijes, si dhe ne levizjen e trenave

Neni 49

Drejtoria e hekurudhes organizon dhe kontrollon punen per mirembajtjen dhe ruajtjen e vijes hekurudhore si dhe per sigurimin e levizjes se trenave sipas kritereve te percaktuara me poshte.

I Kontrollat periodike individuale

a. Rojtari i shines krahas punimeve të caktuara që bëhen sipas grafikut të miratuar nga drejtori i rajonit ose shefi i stacionit hekurudhor, duhet të sigurojë drejtimin e levizjes së trenave gjendjen e vijës hekurudhore ndërkohë dhe urave, tuneleve. Useqeve dhe të ushtrimeve të vecanta në shinat ndërkohë pasijet e shenjezimit dhe të nderlidhjes në vijat telefonike etj, dhe për çdo kontstatim ose demtim më masë për mbrojtjen e trenave dhe lajmëron menjëherë stacionin me të afërt ose përgjegjësit e tij.

Për këto qëllime përcaktohen detyra konkrete në rregulloren e mirëmbajtjes së vijave hekurudhore. Në kohë të keqe dhe sa herë që paraqitet novija ai duhet të dalë në detyrë në zonën e tij.

Rojtari i shines është i detyruar të zbulojë dhe të menjëherë në kohë të gjithë ato defekte në vijën hekurudhore që kërkojnë vetëm pjesëmarrjen e tij. Për defektet e tjera duhet të lajmërojë menjëherë brigadierin ose stacionin me të afërt.

Vendet e rrezikshme për levizjen e trenave rojtari i shiens duhet menjëherë të njoftojë me shenjat e dallimit të trenit.

b. Brigadieri i mirëmbajtjes së vijës hekurudhore drejton punën e brigadës së tij dhe njëherë në 5 ditë kontrollon me hollësi vijën hekurudhore, veprat e artit, kthesat dhe vendkalimet.

Një herë në 10 ditë në prani të dispecerit të qarkullimit (ndërsa në stacionet ku ai mungon në prani të inspektorit të shërbimit) kontrollon ndërkohë, izolimet për të cilat duhet të tregojë kujdes të vecantë, sidomos gjatë kalimit të mjeteve hekurudhore mbi to dhe të marrë masë në vend për menjanimin e të metave të konstatuara.

Një herë në muaj bëjnë kontrollin me spango të kthesave në zonën e tij.

c. Tekniku i vijës hekurudhore vec kontrolleve të vazhdueshme në një herë në muaj është i detyruar të kontrollojë tërësisht në këmbë në të gjithë largësinë e vijës hekurudhore që mbulon si janë zëvendësuar detyrat e caktuara më parë, të shohe gjendjen e vijave hekurudhore, të veprave të artit, të pasijëve, ndërkohë etj, dhe të përcaktojë masat e përgjithshme. Gjithashtu ai kontrollon në mënyrë periodike gjendjen e vendeve me qëndrueshmëri të dobët të tabanit tokësor dhe njëherë në 3 muaj gjendjen dhe madhësinë e rrezeve të kthesave parabolike etj. Në bazë të këtij kontrolli ai drejton dhe planifikon punën e brigadereve të mirëmbajtjes të vijës hekurudhore.

ç Inspektori i shërbimit para amarrjes së detyrës në prani të inspektorit dorezues, duhet të kontrollojë personalisht gjendjen e ndërkohë, paisjet e shenjezimit dhe të nderlidhjes, duke provuar funksionimin e tyre në vend dhe gjendjen e mjeteve hekurudhore që ndodhen në stacion. Gjithashtu ai provon dhe funksionimin e motorrit ndihmes të shenjezimit. Për defektet që konstatojnë lajmëron teknikun e shenjezimit.

Po ashtu ai verifikon ndërkohë të rregullt të shërbimit nga vartësit e vet, të cilët duhet të paraqiten në detyrë me uniforme, të paisur me deshmite e aftësi dhe mjetet e shenjezimit.

Rrezultatet e kontrollit i shënon në librin e marrjes dhe dorëzimit të shërbimit. Për të metat e konstatuara njofton shefin e stacionit dhe përgjegjësit përkatës.

Ai gjatë gjithë kohës së shërbimit inspekton këto probleme dhe kryerjen e detyrës nga vartësit e vet në përputhje me rregullat.

d. Dispeceri i qarkullimit të rajonit ose i stacionit hekurudhor në të gjithë zonën e tij kontrollon jo më pak se tre herë në muaj natën dhe tre herë në muaj ditën, çdo post levizje, duke ushtruar kontroll mbi ushtrimin e detyrave, që përcakton këto rregullore nga punonjësit e këtyre posteve si dhe gjendjen e ndërkohë, vijave hekurudhore, stacioneve, paisjëve të sigurimit teknik të levizjes së trenave, të nderlidhjes dhe shenjezimit. Kontrollon plotësimin në rregull të të gjithë dokumentave të levizjes së trenave kryerjen në kohë e me cilësi të manovrës në shërbimin e pikave të

ngarkin shkarkimit te degezimeve industriale, si dhe nisjen e trenave nga stacioni sipas grafikut te levizjes.

dh. Pergjegjesi i zyres se qarkullimit ne drejtorite rajonale hekurudhore vec kontroleve te vazhdueshme ne zonen e tij, dy here ne muaj naten dhe dy here ne muaj ditën , kotrollon cdo post levizje per te pare si jane plotesuar detyrat nga punonjesit qe sherbejne ne to, gjendjen e nderruesve, ndricimin dhe shenjezimim gjendjen e vijave hekurudhore ne stacion te paisjeve te sigurimit teknik te levizjes, te shenjezimit te nderlidhjes , plotesimin e dokumentave te levizjes, kryerjen ne kohe e me cilesi te punes teknologjike ne sherbimine pikave te ngarkim shkarkimit te degezimeve industriale dhe formimit te nisjes trenave ne kohen e caktuar sipas grafikut te levizjes se tyre. Gjithashtu ai kontrollon dhe instrukton te gjitha punonjesit qe kane lidhje tekniken e sigurimit te levizjes se trenave per zbatimin me perpikmeri te dokumentacionit teknik te stacionit.

e. Tekniket e pasijeve te shenjezimit (elektromekaniku dhe mekaniku i shenjave) vec kontroleve te vazhdueshme e te perditeshme dhe punes per menjanimin e defekteve, nje here ne jave kontrollojne cdo post levizje per gjendjen e rregullt te pasijeve te jashteme e te brendeshme te shenjezimit per veprimin e rregullt te tyre dhe te tryezes se komandimit. Gjate kontrollit duhet ti kushtojte vemendje perdorimit dhe plotesimit ne rregullt te dokumentave perkatese te ketyre paisjeve nga inspektorët e sherbimit, qenies ne rregullt te te gjitha shenjave te zones se tij, dukshmerise se tyre naten dhe ditën veprimin te rregullt te bravave te kontrollit dhe mekanizmit te nderruesve.

Tekniket e pasijeve te shenjezimit jane te detyruar te manjonojne te gjitha defektet dhe nuk duhet te largohen nga puna pa i vene perseri ne gjendje pune normale keto pajise, shenjat dhe aparaturen. Per defektet qe nuk i menjanon dot njofton dhe kerkon ndihmen e pergjegjesit te shenjezimit te rajonit. Te gjita konstatimet dhe verejtjet i shenojne ne librin e paisjeve te shenjezimit dhe ne librin e inspektorit te sherbimit. Po keshtu veprojne edhe kur kane menjanuar defektin duke shenuar datën dhe oren e konstatimit dhe te menjanimit te tij.

é. Fillerojtesi ka per detyre te kontrolloje ne kembe, ne zonen e vet, vijën telefonike nje here ne 15 dite, si dhe te mbaje ne gadishmeri aparatet telefonike te zones se tij. Vemendje te vecante tregon qe aparatet e nderlidhjes te perdoren ne kohen e duhur dhe vetem per qellimin e sherbimit te levizjes se trenave, nga punonjesit qe i kane ne vendin e punes se tyre dhe vetem kur ato ndodhen ne sherbim. Fillerojtesi pergjigjet per gadishmerine e vijes telefonike ditën dhe naten. Mban pergjegjesi ne rast se ne shfrytezimin e hekurudhes futen vija telefonike te huaja ose kryqezohen vija telefonike me ato elektike pa miratimin e drejtorise se hekurudhes.

f. Tekniku i shfrytezimit i nderlidhjes dhe i paisjeve te sigurimit teknik ne drejtorite rajonale hekurudhore, duhet te kontrolloje jo me rralle se nje here ne muaj gjendjen e ketyre paisjeve ne stacionet e rajonit te tij dhe nje here ne 3 muaj, gjendjen e vijave telefonike te rajonit te tij ne kembe.

g. Pergjegjesi i sektorit te shenjezimit ne hekurudhe duhet te kontrolloje jo me rralle se nje here ne 3 muaj gjendjen e pasijeve te shenjezimit te centrlizim-blokimin dhe te atyre te nderlidhjes ne rajonet dhe stacionet hekurudhore. Nje here ne 6 muaj duhet te kontrolloje gjendjen e vijave telefonike.

gj. Inspektori mashinist pervec kontroleve te perditeshme qe kryen ne mjetet hekurudhore dhe ne personelin e lokomotivave e ata kontrollues te vagonave, **kater here ne muaj naten**, kryen kontrole ne sektorin qe mbulon per gjendjen dhe mirembajtjen e lokomotivave, paisjen e tyre me shenjat e duhura te dites dhe nates , gadishmerine e personelit, kryerjen e rregullt dhe ne kohe te kontrollit teknik te vagonave para nisjes se trenit. Krahas punes per instruktimin, ndihmen dhe korrigjimin e te metave ne punen e makinistave per persosjen e teknikes se terheqjes se trenave, vemendje te vecante duhet te tregojte per rrespektimin e shpejtesise se trenave, sipas grafikut per kontrollin teknik te tyre dhe sidomos per menjanimin e pengesave qe shkaktojne vonesen e pa justifikuar te trenave, per nisjen dhe mberritjen e tyre ne perputhje me grafikun e levizjes.

i. Kryekontrollori i vagonave pervec kontroleve te vazhdueshme ne mjetet hekurudhore dhe ne punen e personelit vartes, **4 here ne muaj naten** duhet te kryeje kontroll ne te gjitha ne te gjitha stacionet e zones se tij, ku ka kontrolore vagonash, per gadishmerine e tyre, per kontrollin e mjeteve hekurudhore dhe te trenave, per kryerjen e rregullt te provave te frenave, per paisjen e tyre me veglat e nevojeshme te punes, per ngarkesat e vagonave etj. Ne menyre te vecante kontrolloren punen pergatitore per kontrollin teknik te vagonave gjate kohes se qendrimit dhe perpunimit te tyre ne stacione, ku konstatohen dhe menjahen ne kohe defektet e mungesat, per te bere te mundur nisjen e trenave ne perpikmeri sipas kohes se caktuar ne grafikun e levisjes se tyre.

j. Kryedispeceri ne drejtorite rajonale dhe stacionet hekurudhore, nje here ne muaj naten dhe nje here ne muaj ditën, kontrolloren te gjitha postet e levizjes per zbatimin e rregullave te tyre teknike, per zbatimin dhe rregullshmerise se personelit. Kujdes te vecante tregon ne kontrollin e punes kordinuese dhe te bashkepunimit midis sektoreve te perpunimit te vagonave dhe atij te levizjes, per manovrimin e tyre ne kohe, me cilesi, per formimin e rregullt te trenave, nisjen e tyre ne kohen e caktuar ne grafikun e levizjes si dhe per zbatimin e rregullave nga inspektorët e sherbimit nga dispeceri operativ i turnit dhe nga kryetari i trenit ne nisjen dhe mberritjen e trenave. Gjithashtu ai kontrolloren punen per trajtimin e mallrave.

k. Kryeinxhinjeri ne drejtorite rajonale hekurudhore pergjigjet per tekniken e sigurimit dhe mbrojtjen ne pune ne te gjithë rajonin, si dhe per veprimtarine e dispecerise rajonale. Ai nje here ne muaj naten dhe nje here ne muaj ditën, kontrolloren te gjitha postet e levizjes dhe personelin per kryerjen e punes teknike ne perputhje me rregullat. Gjithashtu kontrolloren si zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune, te mbrojtjes kunder zjarrit nga i gjithë personeli ne punen per levizjen dhe manovrimin e trenave, per ngarkim shkrakimin e vagonave, per riparimin e mirembajtjen e vijes hekurudhore.

I. Shefi i stacionit ne rajonet hekurudhore, 3 here ne muaj naten dhe 3 here ne muaj ditën, kryen kontroll ne te gjitha postet e levizjes se stacionit qe mbulon , si zbatohen rregullat dhe detyrat nga punonjesit e levizjes, te nderruesve, si dhe mbahen dokumentacionet pasijet e sigurimit teknik, te sinjalizimit e te nderlidhjes.

II. Shefi stacionit hekurudhor nje here ne muaj naten dhe nje here ne muaj ditën, kryen kontroll ne te gjitha postet e levizjes se stacionit qe mbulon, si zbatohen rregullat dhe detyrat nga punonjesit e levizjes, te nderruesve, si mbahen dokumentat teknike, paisjet e sigurimit teknik, te shenjzimit e te nderlidhjesi dhe kontrolloren trajtimin e mallrave.

m. Drejtori rajonit hekurudhor nje here ne muaj naten ushtron kontroll ne te gjithë stacionet e rajonin qe mbulon per zbatimin e rregullave, per gjendjen e gadishmerise se personelit ne zbatimin e detyrave te tyre ne disiplinecilesi e ne kohen e duhur. Ai gjithashtu kontrolloren gjendjen dhe veprimin e rregullt te nderruesve, te paisjeve, teknikes se sigurimit, te shenjezimit e te nderlidhjes si dhe trajtimin e mallrave.

Neni 50

Kontrollet individuale do te kryhen ne abaze te grafikut mujor te miratuar nga drejtori i rajonit ose shefi i stacionit hekurudhor per vartesit e tyre dhe nga drejtori i hekurudhes per drejtoret e rajoneve dhe shefat e stacioneve hekurudhore.

Gjate kryerjes se kontroleve individuale cdo epror me i larte verifikon dhe kryen sipas grafikut e me cilesi te kontroleve individuale nga vartesit e vet.

II Kontrollet periodike ekipore

Neni 51

a. Nje here ne muaj kryedispeceri i rajonit ose i stacionit hekurudhor, pergjegjesi i zyres se qarkullimit ne rajonet hekurudhore, dispeceri i qarkullimit, tekniku i shenjezimit te rajonit, brigadieri i mirbajtjes

qe ka ne varesi vijat e stacionit, tekniku i pasijeve te shenjezimit, tekniku u shenjave dhe fillerojtesi, nen kryesine e kryedispecerit, ne menyre te organizuar kryejene kontroll te perbashket ne te gjitha postet e levizjes, nderrueset vijat e stacioneve paisjet e shenjezimit e te nderlidhjes si jane zbatuar dokumentet teknike te stacioneve rregullat dhe detyrat. Ata kontrollojne gjendjen ne vend dhe ballafaqojne punen ne sektoret qe veprojne. Rezultatet e kontrollit nje mujor dhe masast per permiresimin e punes e menjanimin e te metave, i paraqiten me shkrim drejtorit ose shefit te stacionit hekurudhor.

b. Nje here ne tre muaj, nje komision i kryesur nga kryeinxhinjeri ne drejtorine rajonale hekurudhore dhe i perbere nga kryedispeceri, pergjegjesi i zyres se qarkullimit, dispeceri i qarkullimit, tekniku i vijes, shefat e stacioneve te rajonit dhe me pjesmarjen e elektromekanikut te shenjezimit, teknikut te shenjave dhe fillerojtesve ne menyre te organizuar kontrollojne ne kembe vijat hekurudhore, nderrueset, aparatet e shenjezimit te centralizim bllokimit e te nderlidhjes, zbatim te grafikut te levizjes se trenave te rregullave te mbrojtjes nga zjarri, si dhe plotesimin e detyrave nga punonjesis. Ne fund te ketij kontrolli behet analiza ne kolektiv dhe percaktohen detyrat per te ardhmen.

Ne tremujorin kur zhvillohet kontrolli periodik gjashte mujor i drejtorise rajonale inkludohet ne te.

c. Nje here ne tre muaj, nje komision i kryesuar nga shefi i stacionit ne stacionet hekurudhore dhe i perbere nga dispeceri i qarkullimit, tekniku i vijes hekurudhore, me pjesmarjen e teknikut te shenjezimit, teknikut te shenjave dhe fillerojtesit, ne menyre te organizuar kontrollojne ne kembe vijat hekurudhore, nderrueset, aparatet e shenjezimit, te centralizim bllokimit e te nderlidhjes, zbatimin e dokumentit teknik te stacionit, te dokumentimit te levizjes, zbatimin e rregullave te tjera dhe te grafikut te levizjes se trenave si dhe percakton detyrat per te ardhmen. Ne fund behet analiza ne kolektiv.

Ne tremujorin kur zhvillohet kontrolli i pergjitheshem i Drejtorise se Hekurudhes inkludohet ne te.

ç. Nje here ne gjashte muaj , nje komision i kryesuar nga drejtori i rajonit hekurudhor dhe i perbere nga kryeinxhinjeri, pergjegjesi i zyres se qarkullimit, tekniku i vijes hekurudhore, dispeceri i qarkullimit dhe me pjesmarjen e shefave te stacioneve te rajonit, elektromekanikut te shenjezimit, teknikut te shenjave dhe fillerojtesit kontrollojne ne kembe te gjitha stacionet e rajonit, vijat hekurudhore dhe sektoret e tjere per zbatimin e rregullave te sigurimit teknik te levizjes se trenave , per mirmbajtjen e vijave hekurudhore dhe nderruesve, per zbatimin e grafikut te levizjes se trenave si dhe per trajtimin e mallrave. Ne fund percakton detyrat per te ardhmen dhe ben analizen e punes ne kolektiv.

d. Nje here ne vit komisionet e drejtorise se hekurudhave dhe inspektoriatit hekurudhor te kryesuara nga drejtoret dhe zevendesit e tyre kryejne ne kembe kontrollin e pergjitheshem vjetor ne te gjitha rajonet dhe stacionet hekurudhore.

dh. Nen kryesine e kryetarit te deges teknike ne Drejtorine e Hekurudhes te drejtorit te parkut te mjeteve hekurudhore dhe te pergjegjesit te sektorit te mjeteve, me anen e grupeve te kontrollit te formuar prej tyre, kryhen kontrole periodike te mjeteve hekurudhore ne afatet e meposhteme.

Ne vagonat e udhetareve nje here ne muaj.

Ne vagonat e mallrave nje here ne 6 muaj

Ne lokomotivat nje here ne 6 muaj

e. Nje here ne muaj naten grupi i kontrollit i kryesuar nga drejtori i parkut te mjeteve hekurudhore dhe i perbere nga kryeinxhinjeri, pergjegjesi i repartit te qarkullimit, instruktori makinisnt, si dhe 2-3 makiniste, kontrollojne punen e brigadave te lokomotivave ne stacionet hekurudhore

é. Dega e shfrytezimit ne Drejtorine Hekurudhore, me anen e kryetarit te deges ose pjesetareve te tjere te saj nje here ne 6 muaj kontrollojne punen teknike ne drejtorine rajonale dhe stacionet

hekurudhore, zbatimin e dokumentacionit teknik, pershtateshmerine e tij me kushtet konkrete, formimin e trenave dhe punen teknologjike lidhur me kete.

f. Dega e vijave hekurudhore ne drejtorine e hekurudhes me anen e kryetarit te deges ose te pjesetareve te tjere te saj, sebashku me instruktorin makinist dhe tekniket e vijave perkatese, nje here ne muaj kontrollon nga drezina apo lokomotiva gjendjen e vijave hekurudhore dhe te nderruesve. Me nr. 4861/1 dt. 15.03.1991 pika I e nenit 51 te RSHT shtohet “ gjithashtu sipas nevojave ajo kryen kontrolle te pjeseshme ne kembe dhe sontazhe te vecanta si dhe mer pjese drejtpersedrejti ne kontrollin vjetor te linjes.

Neni 52

Rezultatet e kontrolleve individuale dhe ekipore si dhe masat qe meren, shenohen ne librat e kontrolleve qe duhet te ndodhen ne te gjitha postet e levizjes dhe lokomotivat, ku lihen edhe detyrat me shkrim per permiresimin e gjendjes. Ne fund te kontrolleve ekipore lihen detyra me shkrim ne nje dokument te vecante.

Neni 53

Zbatimi ne cilesi dhe ne afat i kontrolleve individuale e ekipore ne te gjitha hallkat, kontrollohet pej inspektoriatit hekurudhor, ne menyre te organizuar nje here ne muaj, dhe ndaj personave qe kontrollet nuk i kryejne sipas afatit ose me cilesi te dobet, mbani qendrim sipas kompetencave qe disponon.

Ne kontrollet periodike 3 mujore, 6 mujore dhe ne ate te pergjitheshem vjetor si dhe ne kontrollin e mjeteve hekurudhore te organizuar nga stacionet, drejtorite rajonale, parku i mjeteve dhe drejtoria e hekurudhes, marin pjese dhe inspektoret e inspektoriat hekurudhor.

Inspektoriati hekurudhor nje here ne 6 muaj njofton me shkrim ministrine e komunikacioneve mbi kontrollin e zbatimit te ketyre rregullave nga te gjitha hallkat si dhe per masat e mara ose qe mendon te meren per permiresimin e punes.

Meremetimi i vijave dhe paisjeve hekurudhore

Neni 54

Meremetimi i vijes hekurudhore, rregullimi i paisjeve te shenjezimit te ndelidhjes, tge sigurmit teknik te levizjes etj, si rregull duhet te kryhen pa nderprerje levizjen e pa ulur shpejtesine e trenave.

Neni 55

Sipas urdherit te ministrit nr. 885 dt. 31.03.1988

Neni 55 paragrafi I dyte behet.

Kryerja e punimeve te medha si rikonstruksionine mesem ose i pergjitheshem i vijave hekurudhore, nderrimi ne mas i shinave apo traversave, meremetimi i tyleneve dhe i urave qe kerkojne nderprerjen e levizjes se trenave mund te behet vetem me lejen e drejtorise se pergjitheshme te hekurudhave e cila mer masat e nevojeshme per kryerjen sa me te shpejte te ketyre punimeve. Ne qofte se eshte e nevojeshme per me teper se 12 ore atehere leja jepet nga ministria e transportit.

Neni 56

Afati i fillii dhe mbarimit te punimeve te cilat kerkojne nje vellim te msadh pune dhe paraqesin veshtiresi per tu kryer, caktohen nga dega e shfrytezimit me bashkepunimme deges e vijave hekurudhore.

Neni 57

Drejtuesi i punimeve gjate kohes se kryerjes se tyre, detyrohet te mbaje lidhje te vazhdueshme me inspektoret e sherbimit te stacioneve fqinje. Ne rast kur eshte e nevojeshme te tregohet nje kujdes i jashtezakonshem nga brigada e lokomotives dhe trenit drejtuesi i punimeve paralajmeron me shkrim stacionet fqinje per rregullimin e vijes hekurudhore ne baze te rregullave te percaktuara ne rregulloren e levixjes se trenave dhe te shenezimit. Ai perpilon plan organizimin e punimeve dhe mban pergjegjesi per cdo shkelje te rregullave te sigurimit teknik.

Rregullimi i mbrojtjes se vendeve te punes dhe i trenit ne vijen hekurudhore ***Neni 58***

Ndalohet :

- a. Fillimi punimve pa u siguruar levizja e trenave me shenjat perkatese ne vendet e punimeve dhe pa marrre masat e nevojeshme per mbrojtjen ne pune.
- b. Largimi i shenjave mbrojtese te vendeve te punimeve para mbarimit te plote te punes dhe verifikimit te qenies ne rregull te vijes hekurudhore, te permases, te permases, grumbullimit dhe sistemimit te materia leve.

Neni 59

Vendet ku kryhen punime qe kerkojne ndalimin e trenit kufizohen si me poshte: Ne largesi 200 mt nga kufiri i zones se punimeve ne te dy anet e saj, vendoset tabela e kuqe e levizeshme ne mesin e vijes hekurudhore. Ne largesi 1.000 mt nga keto tabela vendosen tabelat e verdha te levizeshme per kufizimin e shpejtesise se trenave. Keto tabela duhet te jene te dukshme dhe te ruhen nga punonjes, te cilet qendrojne me shenje dore te kuqe.

Tabela e levizeshme e kuqe duhet te jete nen kontrollin e drejtuesit te punimeve.

Neni 60

Vendet ku kryhen punime dhe kerkojne uljen e shpejtesise se levizjes se trenave, mbrohen nga te dy anet e vijes hekurudhore me shenja te uljes se shpejtesise. Keto shenja vendosen ne kete menyre.

- a. 50 mt larg vendit te punimeve vendoset shenja “ulje shpejtesie” qe tregon vleren me shifra te shpejtesise se lejuar.
- b. 400 mt larg shenjës se mesiperme vendoset shenja “ulje shpejtesie” me ngjyre te verdhe qe kerkon kufizimin e shpejtesise deri ne masen 30 km/ore pa e treguar kete me shifra.

Neni 61

Gjate kohes se kryerjes se punimeve ne vijat hekurudhore brenda stacionit vendosen tabela te kuqe te ndalimit te levizjes, ne mesin e vijes hekurudhore dhe ne largesi 100 mt nga te dyja anet e vendit te punes.

Ne rast se punimet kryhen ne vijat e stacioneve ne largesi me te vogel se 100 mt nga shtegu nderrues qe te shpie ne kete viej, atehere tabela e ndalimit te levizjes vendoset nga ana e kesaj nderruesje ne boshtin e viejs perballe shtegut. Ne kete rast pozicioni i nderrueses duhet te jete i tille, qe te beje te pamundur kalimin e trenit per ne vijen hekurudhore ku kryhen punimet.

Neni 62

Per vendosjen dhe ruajtjen e tabelave te levizeshme qe mbrojne vendet ku kryhen punimet drejtuesi i punimeve cakton punonjesit me pervoje.

Neni 63

Ne vendet ku ka punime voluminose drejtuesi i punimeve duhet te kete lidhje telefonie me stacionin me te afert.

Neni 64

Ndalohen te kryhen punime ne vijat e stacionit te cilat paraqesin rrezik per levizjen e trenave dhe manovren e mjeteve pa lejen e inspektorit te sherbimit dhe pa lene shenime ne librin e kontrollit te vijave hekurudhore, nderruesve te shenjezimit e te nderlidhjes nga drejtuesi i punimeve. Venia ne funksion e pjeses se riparuar te vijes hekurudhore behete vetem atehere kur drejtuesi i punimeve ben shenimet ne librin e kontrollit te vijave hekurudhore dhe pasi ka vene ne dijeni inspektorin e sherbimit te stacionit per mbarimin e meremetimit dhe per gadishmerine teknike te sektorit te meremetuar.

Neni 65

Cdo punonje si hekurudhes duhet te ushtroje vemendje ne vrojtimin e gjendjes se trenave qe kalojne. Ne rast se veren mungese shenjash ose shfrytezim te pa rregullt te meta ne mjetet hekurudhore qe mund te rrezikojne levizjen e trenave (djegje e kushinate te boshteve, vagonave te frenuar, rrota me gropime te theksuara, cati te shkeputura dhe dyer te hapura, mungese parapritesash midis vagonave dhe sidomos ne fundin e trenit, ngarkesa te zhvendosura, musham te liruara, zjarr etj) ose shenja te cilat kerkojne ndihme dhe qe jepen nga brigadat e trenit, atehere menjehere duhet te meren masa per ndalimin e trenit te jepet ndihma per mbrojtjen e tij, per largimin e pengesave qe rrezikojne levizjen e metejshme te trenit.

Rregulli i mbylljes dhe hapjes se vijes hekurudhore per kryerjen e punimeve qe kerkojne nderprerjen e levizjes.

Mbyllja dhe hapja e vijes hekurudhore para fillit dhe pas mbarimit te punimeve behet me urdher te dispecerit te levizjes ne drejtorine hekurudhes ne bashkepunim me teknikun e vijes hekurudhore qe drejton punimet.

Neni 67

Ndalohet fillimi i punimeve ne vijen hekurudhore pa mare lejen e dispecerit te levizjes ne drejtorine hekurudhore dhe pa vendosur shenjat e mbrojtjes se vendit te punes. Hapja e vijes hekurudhore behet prej dispecerit te levizjes ne drejtorine e hekurudhes vetem atehere kur tekniku i vijes (ne raste te vecanta brigadieri) i ben njoftim me telefonogram per meremetimin e vijes hekurudhore.

Neni 68

Vija hekurudhore qe do te mbyllet do te sigurohet nga te dyja anet me tabela te levizeshme te kuqe.

Teknika e sigurimit te levizjes ne vijat hekurudhore gjate ndertimit

Neni 69

Organizimi dhe sigurimi i levizjes se mjeteve ne vijat ne aderti behet nga ndertuesit e vijes sipas kerkesave te kesaj rregullorje.

Kapitulli III

Objektet dhe paisjet e shenjezimit, te centralizimit dhe te nderlidhjes

Dispozita te pergjitheshme

Neni 70

Objektet dhe paisjet kryesore te sigurimit te vijes hekurudhore jane : shenjezimi, centralizim-blokimi dhe nderlidhja. Llojet kryesore te shenjezim-centralizim-blokimit qe perdoren ne hekurudhe jane:

- a. Shenjat, parashenjat dhe shenjat e manovres.
- b. Centralizimi I nderruesve dhe I shenjave
- c. Varesia elektrike me ane te celesave dhe te bravave te kontrollit
- ç. Bllokada elektrike gjysmeautomatike e vijes hekurudhore.
- d. Blloqet mekanike dhe shenjat elektrike ne vijat hekurudhore.

Shenjat

Neni 71

Shenjat sherbejne per sigurimin e vijes hekurudhore si dhe per saktesine e organizimit te levizjes se trenave dhe te punes se manovres.

Neni 72

Te gjitha shenjat dhe aparatet e shenjezimit duhet te jene te tipave te percaktuara ne rregulloren e shenjezimit te miratuar nga ministria e komunikacioneve.

Neni 73

Shenjat e shenjezimit te hyrjes duhet te dallohen qartesisht si ditën ashtu dhe natën ne largesi jop me te vogel se 200 mt. Shenjedhenesi i hyrjes duhet te vendoset jo me afer se 100 mt nga shenja e kufirit te manovres dhe jo me afer se 2600 mt nga hyrja e nderrueses. Shenjedhenesi i daljes duhet te vendoset 50mt larg shtegut korespondues.

Neni 74

Parashenja duhet te vendoset jo me afer se 500 mt nga shenjezuesi i hyrjes. Perpara parashejes vendosen tabelat paralajmeruese ne cdo 100 mt duke filluar nga parashenja. Shenjat e manovres duhet te jene te dukshme jo me afer se 50 mt

Neni 75

Shenjezuesit, parashenjat tabelat e paralajmerimit dhe te gjitha shenjat e tjera vendosen nga ana e djathte e levizjes se trenave

Neni 76

Vendet per vendosjen e shenjave te perhereshme caktohen ne baze te projekteve, te cilat duhet te miratore nga insoektoriati hekurudhor dhe zbatohen nga reparti i shenjezimit.

Neni 77

Ndricimi i te gjitha shenjave duhet te jete i tille qe tge siguroje nje dukshmeri te qarte dhe kuptim te drejte te permbajtjes se shenjes.

Neni 78

Per sigurimin ne kohe dhe pa nderprerje te ndricimit te shenjave mbajne pergjegjesi.

- a. Per shenjehenesit, parashenjat, tabelat e lejimit te manovres, shenjat e nderruesve dhe te nxjerrsesve nga shinat, drejtoret e rajoneve, shefat e stacioneve dhe punonjesit qe sherbejne drejperdrejt ne to.
- b. Per shenjat ne vijar e parkut te mjeteve hekurudhorete bazes mekanike te hekurudhes, te ekonomive te mirembajtes hekurudhore si dhe per shenjat ne vijat hekurudhore te ndermarjeve te tjera ekonomike, drejtoret ose pergjegjesit e ekonomive perkatese.

Neni 79

Ne shenjezimin qe ka te beje me levizjen e trenave perdoren keto ngjyra.

- a. E kuqa kerkon ndalimin e menjehereshem te trenit (shenja ndal)
- b. E verdha kerkon uljen e shpejtesise se levizjes se trenit
- c. E gjelbra dhe e everdha tregojne rruge te lire por me shpejtesi te kufizuar per hyrje dhe dalje nga stacioni.
- ç. E gjelbra lejon levizjen me shpejtesine e caktuar d.m.th. tregon rrugen e lire per te hyre ose per te dale nga stacioni.
- d. E gjelbra qe ndizet e shuhet me ndreprejre kerkon kalimin e trenit me shpejtesine e caktuar pa u ndaluar ne stacion.
- dh.E gjelbra dhe e verdha , te cilat shuhet dhe ndizen njekohesisht me ndreprejre kekojne kalimin e trenit me shpejtesine e caktuar pa u ndalur ne stacion.
- e. E bardha qe ndizet dhe shuhet me ndreprejre (shenje rezerve) kerkon levizjen e trenit me shpejtesi jo em te madhe se 15km/ore per hyrje ne stacion , per dalje nga stacioni duke u paisur me urdher te vecante.

é. Dy drita te bardha ne tabelen e elejimit te manovres ose ne shenjdhene (shenja manovres) lejojne kryerjen e manovres ne vijen hekurudhore ose ne grupin e vijave, ku eshte vendosur tabela e lejimit te manovres.

Varesia me ane te celesave dhe te bravave te kontrollit

Neni 80

Paisjet e varesise me ane te celesave duhet te garantojne lidhjet e perbashketa te nderruesve dhe te shenjes ne shenjdhene e hyrjes dhe te daljes me ane te bravave te kontrollit te nderruesve te shenjave duke krijuar keshtu varesine e veprimeve te nderruesve me veprimet e inspektorit te sherbimit ne tryezen e komandimit.

Neni 81

Brava e kontrollit te nderrueses duhet.

- a. Te lejoje marjen e celesit vetem pasi te jete kycur nderruesja.
- b. Te garantoje kycjen e nderrueses vetem em pozicionin qe tregohet ne kycin e nxjerre prej braves, me kusht qe gjilpera the puthitet plotesisht me shinen baze.
- c. Te mos lejoje kycjen e nderrueses kur ndermjet gjilperes se shtrenguar dhe shines baze mbetet nje hapshire 4 mm ose me teper.
- d. Te mos lejoje nxjerrjen e celesit kur eshte pergatitur rruga e kalimit dhe eshte hapur shenje per daljen ose hyrjen e trenit ne stacion.

Neni 82

Nuk lejohet perdorimi I bravave me te njejtin celes Brenda kufijve te te njejtin stacion.

Brava e varesise elektrike duhet te jete e plumbosur. Ne mungese te energjise elektrike, me urdher te inspektorit te sherbimit te stacionit ate e cplumbosun duke shenuar ne linrin e paisjeve te shenjezim-bllokimit arsyen dhe kohen e cplumbosjes.

Neni 83

Paisjet mbrojtese (nxjerresit nga shinat) ne pozicionin e brojtes, nuk duhet te lejojne levizjen e mjeteve hekurudhore ne vijen ku ato jane vendosur. Keto paisje duhet te jene te kompletuara me shenjate perkatese.

Neni 84

Paisjet e nderlidhjes per komunikimin e urdherave urgjente, duhet te sigurojne kontaktin eshpejte ndermjet punonjesve qe kane te bejne me levizjen e trenave.

Neni 85

Ne hekurudhe perdoren keto tipa kryesore te nderlidhjes.

- a. Nderlidhja lokale ndermjet 2 stacioneve fqinje per pranimin dhe paisjen e trenave
 - b. Nderlidhja e pergjitheshme per komunikimin e dispecerit te levizjes se trenave me stacionet
 - c. Nderlidhja e nderruesve per bisedime zyrtare me inspektorin e sherbimit dhe me bllloqet e vendkalimeve.
 - ç. Linja e pergjitheshme per pune operative administrative
- Per transmetimin e urdherave punonjesve te stacionit si dhe per formimin e udhetareve, ne stacion perdoren qendrat e zerit.

Neni 86

Ndalohet kategorikisht lidhja e telefonave te tjere me telefonat e nderlidhjes lokale te stacioneve, si dhe ato te nderlidhjes me bllloqet e nderruesve.

Neni 87

Linja e shenjeimit dhe te nderlidhjes mund te jene ajrore ose me kabloo nentokesore.

Neni 88

Largesia nga toka e pikes me te ulet te telave te linjave te shenjeimit dhe te nderlidhjes duhet te jete jo me pak se 2.5 m ne vijat hekurudhore, ne stacione jo me pak se 3 m ne kalesat hekurudhore jo me pak se 4.5 m dhe ne nderprerje me vijen hekurudhore jo me pak se 6.5 m nga koka e shines.

Neni 89

Paisjet e shenjeimit dhe te nderlidhjes duhet te sigurojne mbrojtjen nga ndikimet ngacmuese dhe nderhyrese te vijave fqinje, te vijave qe kryqezohen me to, si dhe nga shkarkimet atmosferike.

Mirembajtja e paisjeve te shenjeimit dhe te nderlidhjes

Neni 90

Ne zyrat ku jane vendosur aparaturat e shenjeimit, te centralizimit dhe te nderlidhjes qe I sherbejne levizjes se trenave ndalohet kategorikisht hyrja e personave qe kane te bejne me sherbimin dhe perdorimin e tyre.

Keto paisje dhe aparatura sherbehen vetem nga punonjes te autorizuar dhe vetem ateher kur keta kryejneturnin e sherbimit te tyre.

Neni 91

Celesat e takimit me rendesi (celes grupi) ne tryezen e komandimit, duhet te jene te mbyllur dhe plumbosur. Hapja e tyre lejohet te behet vetem nga punonjes kompetente te sektorit te nderlidhjes dhe te shenjeimit, duke bere shenimet perkatese te rregjistrimit e te kontrollit te ketyre paisjeve ne librin e rregjistrimit.

Punonjesit qe jane ne sherbim kane pergjegjesi si per prekjen pa arsye te plumbosjes.

Neni 92

Ndryshimet e perkoheshme ne varesine e paisjeve dhe te nderlidhjes mund te kryhen vetem me lejen e pergjegjesit te ketij sektori, me nje afat jo me te gjate se 12 ore. Ndryshimet me afat te gjate mund te behen vetem me urdherin e inxhinjerit te shenjeimit.

Neni 93

Ndalohet te kryhen punime per pastrimin riparimin dhe nderrimin e aparateve te shenjeimit dhe te bllokimit pa njoftuar inspektorin e sherbimit te stacionit dhe pa bere shenime perkatese ne rregjistrin e kontrollit te ketyre paisjeve.

Neni 94

Prova e paisjeve ne perdorim (shenjeim-blokimit) duhet te kryhet me pelqimin dhe nen kontrollin e inspektorit te sherbimit te stacionit.

Pergjegjesi I paisjeve te shenjeimit dhe nderlidhjes eshte I detyruar te njohe me saktesi gjendjen e te gjitha paisjeve (shenjeimit, centralizimit dhe te nderlidhjes) ti provije ato sistematikisht, si me anen e personelit te tij vartes ashtu dhe personalisht, duke garantuar punimin normal te te gjitha ketyre paisjeve ne stacione. Kryen punime per mbajtjen ne gadishmeri te tyre, sipas nje grafiku te caktuar, duke garantuar ne pune pa nderprerje, si dhe dukshmeri normale te shenjave. Nje here ne muaj tekniku I zones kontrollon dukshmerine e shenjave dhe mer masa urgjernte per te gjitha crregullimet qe konststaton.

Neni 95

Tekniku I merembajtjes se ketyre paisjeve eshte I detyruar te dije dhe te kryeje te gjitha punimet per funksionimin e sakte te tyre duke menjanuar urgjentisht defektet u, pa nderprere veprimtarine e aparatures. Ne rast pamundesie per te rregulluar vete defektin, njofton drejtorine e rajonit, shefin e stacionit dhe pergjegjesin e sektorit te shenjezimit ne rajon ose stacion.

Neni 96

Mekaniku I paisjeve te shenjezimit eshte I detyruar te menjanoje ne kohe defektet te lajmeruara dhe para fillimit te punes te vere ne dijeni inspektorin e sherbimit.

Neni 97

Punonjesit e montimit te paisjeve te shenjezim-blokimit dhe te nderlidhjes duhet te njohin dhe te zbatojne rregullat e punimit ne nderrueset dhe ne vije, duke marre te gjitha masat e sigurimit per levizjen e trenave deh masat per sigurimin e tyre.

Neni 98

Teknikeve te ketyre paisjeve iu ndalohet te kryejne punime pa marre lejen me shkrim nga inspektori I sherbimit.

Ndalohet te kryejne punime ne nderrueset dhe ti levizin ato nga nje pozicion ne tjetrin, pa lejen e inspektorit te sherbimit. Gjate punimit ne motorret e nderruesve dhe te shkycjes se tyre per riparim duhet te sigurojne nderrueset me brave mekanike ne p ozicionin e caktuar, sipas marreveshjes me inspektoirn e sherbimit.

Keta punonjes duhet te njohin dhe te zbatojne me perpikmeri nenet e kesaj rregullorje dhe rregullooren e shenjezimit.

P J E S A E D Y T E MJETET HEKURUDHORE DHE MIREMBAJTJA E TYRE

***Kapitulli I* Dispozita te Pergjithshme**

Neni 99

Ne mjetet hekurudhore bejne pjese lokomotivat, vagonat e udhetareve dhe te mallrave, vincat hekurudhore, si dhe mjetet e tjera te vecanta.

Neni 100

Karakteristikat teknike te mjeteve qe perdoren ne hekurudhat e Shqiperise si dhe projektet e mjeteve te reja, qe do te prodhohen ne vend, miratohen nga ministria e komunikacioneve.

Neni 101

Eshte e ndaluar qe pa lejen e ministries se komunikacioneve tju nderrohet konstruksioni mjeteve hekurudhore qe jane ne shfrytezim.

Neni 102

Riparimi, sherbimi dhe kontrolli I mjeteve hekurudhore do te kryhen sipas afateve te percaktuara ne grafikun e riparimit dhe me cilesine e nevojeshme.

Neni 103

Mjetet hekurudhore ne gjendje te ngarkuar ose bosh, ne asnje pjese te tyre nuk duhet te dalin jashte permases se mjeteve levizese.

Neni 104

Mjetet hekurudhore duhet te mbahen vazhdimisht ne gjendje te rregullt teknike dhe plotesisht te afta per pune. Menjanimi I shkaqeve qe sjellin cfaredo lloj difekti duhet te jete detyra kryesore e punonjesve qe jane pergjegjies per mirembajtjen e mjeteve hekurudhore.

Neni 105

Cdo mjet hekurudhor duhet te kete pasaporten teknike ne te cioen shenohen karakteristikat kryesore si datea e prodhimit dhe e fillimit te punes, kilometrazhi I pershkruar, ndryshimet ne konstrukcion, nderrimi I agregateve me kryesore, gjithashtu te dhena mbi riparimet kryesore dhe kontrollin e pjeseve me te rendesishme.

Kapitulli II **LOKOMOTIVAT**

Neni 106

Lokomotiva eshte mjet hekurudhor kryesot terheqes.

Neni 107

Cdo mjet duhet te kete mbishkrimet e meposhteme: stemen e shtetit, serine dhe numrin, tabelen e fabrikes, shpejtesine e konstruktuar, si dhe vendin dhe daten e kryerjes se riparimit te fundit. Lokomotivat duhet te jene te paisura me matese e rregjistruese te shpejtesise te plumbosura.

Neni 108

Sipas urdberit te ministrit nr.885 dt.31.03.1988 ky nen biqet komplet.

Kazanet e avullit te lokomotivave

Neni 109

Cdo kazan locomotive duhet te kete.

- a. Dy aparate (injektore) uji ne gjendje pune te pavarur nga njeri tjetrisecili ne gjendje te furnizojte kazanin me sasin e ujit te nevojeshem per shfrytezimin maksimal te tij.
- b. Te pakten 2 aparate e niveltreguesa ne gjendje te mire, qe te tregojne nivelin e ujit ne kazan: te pakten njeri nga keta aparate duhet te kete niveltregues xhami. Ne niveltreguesin duhet te jete shkallezimi qe shenon nivelin minimal ne kazan per pjerresine 0 %, 10 %, 25 %, 40 %
- c. Dy ventila sigurimi me pasije qe ndalojne tejkalimin e presionit maksimal te punes ser tyre.
- ç. Te pakten nje manometer presionin e kazanit: manometri duhet te kete ne fushen e shkallezuar nje vije te dukshme te kuqe, qe lejon presionin maksimal te lejuar ne kazan: ai duhet te provohet sistematikisht dhe ne te shenohet data e proves dhe shenja e brigades qe beri proven: ne tubacionin e marjes se avullit nga manometri, duhet te kete nje vend per vendosjen e nje manometri te kontrollit.
- d. Te pakten nga nje plumb sigurimi te vidhosur ne pjesen e perpareshme dhe te mbrape te tavanit te kutise se zjarrit.
- dh. Te shenuar ne tabelen metalike, te montuar mbi deren e furres, nje vije hotizontale qe tregon nivelin maksimal te ujit: kjo shenje duhet te jete te pakten 100 mm mbi piken me te larte te tavanit te kutise se zjarrit te lagur nga uji.
- f. Te shenuar ne tabele dhe keto te dhena: emri i prodhuesit, numri i prodhimit, viti i prodhimit, presioni maksimal i lejuar, si dhe pika me e larte e tavanit te kazanit te lagur me uje: tabela fiksohet ne menyre te palevizeshme.
- g. Te plumbosur manometrin dhe ventilat.

Kazani i cdo lokomotive kontrollohet dhe provohet ne afate te percaktuara n udhezime te vecanta nga inspektori i eneve nen presion.

Neni 110

Sipas urdberit te ministrit nr.885 date 31.03.1988 bebet.

Ndalohet puna ne shfrytezimin e lokomotivave qe ka nje nga aparatet e meposhteme te difektuara, matesin e rrotullimit te diezelit, termometrimit e ujit te motorrit, manometrimit e presionit te vaajit, naftes, ajrit te turbines, manometrimit e presionit te rezervuareve kryesore te ajrit, rezervuareve ndihmes, cilindrave te frenimit, dhe te tubit kryesore, matesin e fuqise se gjeneratorit, matesin e ngarkimit te baterive si dhe mates rregjistruer te shpejtesise. Locomotiva e trenit te pasagjerive e cisternave te amoniakut dhe te lokomotivave qe punojne ne pendence mbi 15 %dhe difektohet aparati mates-rregjistruer, atehere sato lejohen te punojne deri ne piken me te afert te riparimit, lokomotivat e tjera qe difektohet ky aparat do te lejohen te punojne deri ne sherbimin e rradhes. Lokomotivat e caktuar si manovarkere stacion duhet te kete ne funksion aparatit mates se shpejtesise.

Neni 111

Sipas urdberit te ministrit nr. 885 date 31.03.1988 bebet

Ciftet e rrotave duhet tu nenshtrohen kontroleve dhe riparimeve sipas cikleve te parashikuara nga drejtoria e pergjitheshme te hekurudhave.

Boshtet, rrotat e rrethoret e ciftit, duhet te kene te stampuara shenjat e febrikes, numrin e derdhjes, daten e provimit. Boshtet pervec ketyre duhet te kene numrin e inventarizimit dhe daten e riparimit. Kjo shenje nbahet ne kartela te vecanta per cdo cift.

Largesia ndermjet faqeve te rendesishme te rrothoreve duhet te jete 1360mm . Ndryshimi I kesaj madhesie ne zmadhim ose ne zvogelim nuk lejohet te jete me teper se 3mm.

Neni 112

Largesia ndermjet faqeve te brendeshme te rrethoreve duhet te jete 1360mm. Ndryshimi I kesaj madhesie ne zmadhim ose ne zvogelim nuk lejohet te jete me teper se 3mm.

Gjeresia e rrethoreve duhet tu pergjigjet masave te percaktuara ne rregulla te vecanta te miratuara nga Ministria e komunikacioneve.

Neni 113

Ndalohet perdorimi I lokomotivave per terheqjen e trenave dhe per levizjen e tyre kur ne ciftin e rrotave kane nje nga te metat e meposhtme.

- Rrethoret e rrotave ose ne boshtin ne qender te rrotes se lira.
- Edhe nje plasje te vetme kryesore ne bosht.
- Plasje gjatesore ose gervishtje ne bosht mbi 25 mm
- Vende te konsumuara me kende te mpehta ose ne thellesi mbi 2m
- Te plasura ne rrethore ose ne rroten e dhembzuar.
- Konsum te rrethoreve ne sieprfaqen e takimit, matur ne planin e rrethit te takimit mbi 6mm.
- Ngrenie lokale te rrethores ne siperfaqen ed takimit, matur ne planin e rrethit te takimit me thellesi mbi 1.5mm (per te shkuar ne piken e riparimit te levize me shpejtesi 20km/ore)
- Gervishtje ne siperfaqen e takimit te rrethores me gjatesi mbi 25 mm dhe thellesi mbi 2mm

- Trashesi te rrethores ne planin e rrethit te takimit (matur gjate rrezes se konsumit me te madh) me te vogel se 30mm (pa matur trashesine e patentes 10 mm)
- Trashesi te buzeve te rrethores (matur ne rrethin e bere me rreze 10 mm me te madhe se rrezja e rrethit te takimit) me te vogel se 22 mm.
- Lartesi te buzeve te rrethores (matur nga rrethi i takimit ne vendin e konsumit me te madh) me te vogel se 25 mm dhe me te madhe se 36 mm.

Nuk lejohet marrje metali nga papule e frenici me lartesi me te madhe se 1.5 mm. Shpejtesia e levizjes se trenit deri ne piken e riparimit lejohet dri ne 20 km/ore.

Riparimi, mirembaajtja dhe sherbimi i lokomotivave

Neni 114

Gjendja teknike e lokomotivave verifikohet ne keto raste.

- Para hyrjes dhe daljes nga oficina nga controllori i cilesise per cfaredo lloj sherbimi qe u behet.
- Cdo dite nga personeli i lokomotives kur ajo ndodhet ne kanal.
- Pas cdo avarie, nga nje komision teknik i kryesuar nga kryeinxhinjeri i parkut te mjeteve hekurudhore.
- Nje here ne 6 muaj nga komisioni i kontrollit periodik.

Neni 115

Kur kontrullohet gjendja teknike e lokomotivave, verifikohet gjendja e sistemit te levizjes, te frenimit, ganxhimit parapritjes, te motorrit apo te kazanit si dhe te paisjeve te tjera te lokomotives.

Neni 116

Nuk lejohet te dalin ne qarkullim dhe te lidhen me trena lokomotivat qe kane te metat e meposhteme.

- Shenjen tingelluese (sirenen) te prishur.
- Mungese dhe mosfunksionim te rregullt te ndricimit te shenjave.
- Mosfunksionim te rregullt te sistemit te frenimit automatic, direkt dhe mekanik.
- Mosfunksionim te rregullt te sistemit te reres ose pa rere ne rezervuar.
- Mosfunksionim te rregullt te sistemit te vajisjes.
- Plasje ne karete, ne bilancier, ne mbajtesen e sustes ose ne sustat spirale.
- Mungesa te paisjeve te mbrojtjes kunder zjarrit.
- Me kushinete te boshteve te demtuar ose me plasje te kutise se kushienetes.
- Me bullona te liruara ne lidhjet e shasises apo motorrit.
- Mosfunksionim te rregullt te aparateve te ganxhimit dhe te parapritjes.
- Mosfunksionim te aparatit treguar dhe rregjistruer te shpejtesise.

Vec ketyre ndalohet terheqja e trenave me lokomotivat qe kane edhe nje nga te metat e meposhteme.

a. Ne lokomotivat me avull

- Mosfunksionim te rregullt te ventilimit te sigurmit te kazanit.
- Mosfunksionim te rregullt te mjeteve te furnizimit (aparatet e ujit etj)
- Plasje ne faqet e kutise se zjarrit, te kazanit certikal ose te tri percinave te vendosura prane njera tjetres.
- Mosfunksionim te rregullt te manomtrave te kazanit.
- Mosfunksionim te rregullt te rubinetave trguese te ujit ose te xhamave tregues te ujit.
- Rrjdhje ne plumbat e sigurimit
- Shkritje ose ngrohje te kuzhinetave te mekanizmave ose te bushtit.
- Perkulje ose plasje ne mekanizmat
- Thyerje ne fashot e pistonave
- Mosfunksionim te rregullt te paisjeve kunder xixave.

- Lirim te bullonave te cilindrave.
- Rregullatore te defektuar.

b. Ne lokomotivat elektro-diezel

- Mosfeksionim te rregullt te sistemit te furnizimit me vaj, uje dhe lende djegese.
- Punim jo te rregullt te motorrit
- Shkrirje ose demtim te kuzhinetes kryesore te bjelles ose bangos se motorrit
- Mosfeksionim te rregullt te paisjeve per ftohjen e ujit dhe vajit.
- Mosfeksionim te rregullt te motoreve elektrike ose te kushinetave te tyre.
- Plasije te kutise se transmisionit me dhembe, qe shkakton rrjedhje vaji.
- Plasje ose thyrje te ndonje dhembit te ciftit koron-pinjon.
- Baterite e konsumuara ose te prishura.
- Mosfeksionim te rregullt te ftohjes se motorreve elektrike.
- Shfryerje ne kolektorin e shkarkimit te gazeve, te cilat rezikojne shperthimin e zjarrit.

Neni 117

Sipas urdherit te ministrit 4723 dt. 11.12.2013

Afatet e riparimit te mjeteve hekurudhore perгатiten ngas njesia e ngarkuar per riparim, ne baze te ciklit te riparimit te rekomanduar nga fabrika prodhuese. Per te gjitha vagonat e udhetareve, hyrja ne riparim do te behet.

- Cdo 12 muaj, per ato vagona udhetarsh qe kane pershkruar mbi 60.000 km ne vit.
- Cdo 18 muaj per vagonat e tjere te udhetareve.

Lejohet tejkalimi i ketyre afateve deri ne 14 dite.

Afatet maksimale te parashikuara me siper mund te ulen ne varesi te kushteve te shfrytezimit dhe nqs prodhuese ka rekomandime te vecanta.

Neni 118

Sipas urdherit ministrit 4723 dt.11.12.2003

Hyrja dhe dalja e mjeteve hekurudhore per riparim duhet te behet ne perputhje me grafikun e riparimit te miratuar nga drejtoria e pergjithshme e hekurudhave. Ndryshim ne kete grafik mund te beje vete ajo kur bindet se garantohet nje pune e sigurte e ketyre mjeteve.

Per vagonat e udhetareve te zbatohen kriteret e neneit 117.

Neni 119

Pergjegjes per cilesine e riparimeve jane punonjesit qe marin pjese drejtperdrejt me riparimin, punonjesit e kontrollit teknik dhe punojesit e caktuar me marjen e mejtit ne dorezim

Neni 120

Ne cdo lokomotive duhet te jene 2 persona ne sherbim. Makinisti dhe ndihmesi i tij.

Ne vendet e riparimit mund ti sherbeje lokomotives se ndezur nje njeri i pajisur me deshmi aftesie.

Neni 121

Ndalohe lenia e lokomotives ne gjendje pune, ne vijat hekurudhore, te levizjes se trenave, ne stacionet, pa mbikqyrjen e brigades se lokomotives qe eshte ne sherbim.

Neni 122

Pastrimi i furres dhe shfryrja e kazanit te lokomotives me avull, duhet te kryhet ne vendet e caktuara per kete pune.

Kapitulli III
VAGONAT
Neni 123

Vagonat hekurudhore ndahen ne vagona udhetaresh dhe vagona malli.

Ne vagonat e udhetaresh bejne pjese.

Vagonat per transportin e udhetaresh placave, te postes dhe vagonat speciale.

Ne vagoant e mallrave bejane pjese.

Vagoant e mbyllur , vagoant e hapur me sponde mbi 50 cm, vagoant platforme me sponde te uleta nen 50 cm, vagona te tjere si veteshkarkues, cisterne, vagona speciale, gjithashtu dhe vagona me paisje per nevoja teknike dhe administrative te hekurudhes si dhe vagona te tjere

Neni 124

Te gjithe vagonat duhet te kene shenjat dhe mbishkrimet e meposhteme.

Sipas urdherit te ministrit nr.4723 dt. 11.12.2003

Stemen e hekurudhes, serine dhe numrin e inventarizimit, peshen vetjake, daten e riparimit te fundit vjetor (per vagonat e udhetaresh daten e riparimit te fundit periodik) te mesem, themelor, largesine midis dy boshteve shenjen e boshteve dhe sistemin e frenimit.

Vagonat e transportit nderkombetar, pervec ketyre duhet te kene edhe shenjat e parashikuara ne rregulloret e RIV, RIC, dhe UIC

Gjithashtu vagonat e udhetaresh duhet te kene mbishkrimet per sasine e vendeve per tu ulur, gjatesine, peshen vetjake, ndricimin dhe vagonat e mallrave kapacitetin dhe ngarkesen, siperfaqen e dyshemese, gjatesine dhe vellimin e ngarkimit dhe shenjat e shkarkueses elektrike per cisternat.

Neni 125

Vagonat lejohen te vihen ne shfrytezim, vetem pasi te jene kontrolluar dhe te plotesojne te gjitha kushtet teknike te nevojeshme.

Ciftet e rrotave te vagonave

Neni 126

Ciftet e rrotave te vagonave duhet tu nenshtrohet rregullave te riparimit dhe te kontrollit te tyre. Ne boshtet rrotat dhe rrethoret e ciftit te rrotave duhet te jene te stampuara shenjat e prodhimit nga fabrika, kurse ne boshtet, edhe data e riparimit te fundit.

Neni 127

Sipas urdherit te ministrit nr. 885 dt. 31.03.1988 behet.

Largesia ndermjet faqeve te brendeshme te rrethoreve duhet te jete.

- Per rrotat me diameter nga 840 mm deri ne 1000 mm duhet te jete 1360+ - 3 mm
- Per rrotat me diameter me te vogel se 840 mm duhet te jete 1360+ - 3 mm

Neni 128

Ndalohet vendosja ne tren e vagonave, te cilat kane ne ciftet e rrotave qofte edhe vetem nje nga te metat e meposhtme.

- Lirimi I rrotes se mbathur nga boshti ose lirimi I rrethores nga rrota e zbathur.
- Saldime ne bosht ose boshte te shtremberuar
- Plasje terthore te boshtit ne cfaredo vendi.
- Plasje ose gervishtje gjatesore ne bosht me te madh se 25mm
- Vende te ngrena ne bosht me thellesi me te madhe se 2.5 mm

- Plasje ne rrethore ose ne rroten e zbathur
- Konsum i rrethores ne siperfaqen e taakimit, matur ne planin e rrethit te takimit, me te madhe se 6 mm per vagonat e udhetareve dhe 8 mm per vagonat e mallit.
- Ngrenie lokale e rrethores ne siperfaqen e takimit me gjatesi me te madhe se 60 mm ne vagonat e mallit. Ne vagonat e udhetareve nuk lejohen ngrenie te tilla.
- Gervishtje ne siperfaqen e takimit te rrethores me gjatesi mbi 25 mm dhe thellesi mbi 2 mm. Per vagonat e udhetareve nuk lejohet gervishtje.
- Trashesia e rrethores ne rrethin e taakimit me e vogel se 30 mm per vagonat e udhetareve dhe 25 mm per vagonat e mallit. Per rrotat pa rrethore (monobllok) per vagonat e mallrave deh udhetareve prodhuar deri me 31.12.1954 diametri me i vogel i lejuar ne rrethin e rrokullisjes eshte 820 mm ndersa per ato te prodhuara pas dates 01.01.1955 diametri me i vogel i lejuar ne rrethin e rrokullisjes eshte sipas tabelës.

| Diametri minimal mm | diametri me i vogel i lejuar mm |
|---------------------|---------------------------------|
| 1000 | 920 |
| 920 | 840 |
| 840 | 760 |
| 760 | 680 |

- Trashesi te buzës se rrethores, matur ne 10 mm mbi diametrin e rrokullisjes, me e vogel se 22 mm per rrotat me diameter nga 920mm deri ne 840 mm
- Lartesi te buzës se rrethores, matur nga diamteri i rrokullisjes me e madhe se 36 mm
- Per rrotat qe jane prodhuar ne shtetet e pa aderuar ne UIC zbatohen rregullat e shtetit prodhues.

Ciftet e rrotave te vagonave qe kryejne riparimin e mesem dhe themelor duhet te kontrollohen ne ***Neni 129***

defektoskop duke bere shenimet perkatese ne bosht dhe ne kartelet.

- Ndryshimi i diametrale te dy rrotave ne nje bosht nuk lejohet me teper se 1mm
- Ndryshimi ndermjet rrotave te nje karrete nuk lejohet me teper se 10 mm ndersa rrotave te nje vagoni jo me teper se 20 mm.
- Kontrolli dhe riparimi i boshtevve behet ne oficine nga punonjesit qe duhet te kene dhene provim per kete pune.

Kontrolli dhe riparimi i vagonave

Neni 130

Vagonat para nisjes dhe mbas mberitjes se tyre ne stacion, gjithashtu edhe mbas cdo avarie, kontrollohen prej kontrollit te vagonave, i cili pergjigjet per lidhjen ne tren te vagonave me te meta teknike. Ai kontrollon ciftet e rrotave, kutine e kushinetes, balestrat, sistemin e frenimit, sistemin e lidhjes, parapritesit, si dhe mbylljen e dyerve e te dritareve.

Neni 131

Ndalohet lidhja ne tren e vagonave qe kane qofte edhe nje nga te metat e meposhteme.

- Per ciftet e rrotave vlejne te dhenat e neneve 128,129
- Plasje te shasisë, karretes, plasje te vesheve te balestres, kavallotes, pajsje ose thyerje te piruneve rreshqites te kutise te kushinetes ne drejtim tethor, thyerje ose perkulje te spinotit te shasisë.
- Menjanime te largesive te jashtme te planve te piruneve rreshqites te kutise se kushinetes, ne drejtim tethor me gjatesi e aksit prej 1 deri ne 3 mm

- Thyerje ose shtremberime te piskutines ose balestrave.
- Zhvendosje te balestres ose fijeve kryesore ne drejtim per se gjsti, me shume se 20 mm ne akset e fiksuara dhe me shume se 10 mm ne vagonat me karreta, duke llogaritur nga brinja e kavallotes se balestres.
- Plasje ose thyerje te fijes kryesore te balestres.
- Thyerje te fijes se balestres ndermjetesise, ku vendi I thyerjes eshte I larguar nga qendra e kavallotes se balestres me shume se $\frac{1}{4}$ e gjatesise se plote te fijes se keputur dhe mungon pjesa e saj.
- Mosfunksionim te rregullt te sistemit te lidhjes dhe paraprites.
- Thyerje ose plasje ne traversat e shasis.
- Mungesa ne shasi, dysHEME ose mure anesore te cilast lejojne hyrjen e lageshtires brenda ne vagon ose dalje e ngarkeses prej tij.
- Thyerje ose plasje te jastekeve nen rezervuarin e cisternave
- Zhvendosje te rezervuarit te cisternes ne jastek
- Rrjedhje sa do te vogel te botit.
- Menjanim te karrocerise se vagonit mbi 75 mm ne vagonat e mallrave dhe mbi 20 mm ne vagonat e udhetareve.
- Demtim te kutise se kushientes, qe shkakton derdhjen e vajit, si dhe shkrirje ose plasje kushinete.

Neni 132

Ne trenin e udhetareve ndalohet vendosja e vagonave.

- Kur kane te meta te theksuara ne drejtim te paraqitjes estetike te jashteme dhe te brendeshme
- Kur kane demtim te ures se kalimit ose te bravave te dyerve qe rrezikojne sigurimin e udhetareve
- Kur kane te meta ne sistemin e frenimit dhe ndricimit

Hermeticiteti i sistemit te frenimit duhet te jete i tille qe te mos lejoje renie presioni me shume se 0.1 atm per 1 minute. Rezerva te frenimit te dores duhet te jete 75 mm kur papucia eshte e bashkuar me rrethoren. Konsumi maksimal i papuces se vagonave lejohet deri ne 20 mm.

- Kur kane te meta ne sistemin e levizjes, te cilat rrezikojne levizjen e trenit
- Kur kane te meta ne sistemin e lidhjes

Nuk lejohet levizja e vagonave qe nuk kane spinotin e fiksimit te ganxhes automatike me kopilen e sigurimit

Per cilesine e kontroleve te sherbimeve e te riparimeve mbajne pergjegjesi punetoret qe kryejne keto detyra, mjeshtrat dhe pergjegjesit e parkut te mjeteve hekurudhore dhe te bazes mekanike

Neni 133

Sipas urdherit te ministrit nr 885 dt. 31.03.1988 behet

Kerkesat e tjera teknike qe duhet te plotesojne vagonat hekurudhore caktohen ne udhezime te vecanta te nxjerra nga drejtoria e parkut te hekurudhave.

Parapritesit dhe pasijet e lidhjes

Neni 134

Lokomotivat dhe vagonat duhet te kene ne ted y anet parapritese dhe pasije lidhje sipas tipave qe plotesojne kushtet teknike.

Largesia e qendres se parapritaesve dhe te lidhjes nga siperfaqja e siperme e kokes se shines nuk duhet te jete me e madhe se 1065 mm dhe me e vogel se 940 mm

Lidhesit (ganxhat) automatike

Neni 135

Lartesia e boshtit te lidhur e matur vertikalisht me siperfaqen e kokes se shines dhe kur vagoni eshte ne qetesi duhet te jete.

- Per mjetet bosh 1045 mm

- Per mjetet plot 950 mm

- Per mjetet e transportit te paisura me ura kaluese minimalja 960 mm

Lidhesi duhet te bashkohet ne menyre te sigurte me nje diference ndermjet akseve gjatesore te kokave te lidhesit deri ne 75 mm.

Kapitulli IV

Frenat

Neni 136

Sipas urdherit te ministrit nr 885 dt. 31.03.1988 behet.

Cdo lokomotive dhe vagon udhetaresh duhet te kete frena automatike dhe frena dore ne funksion te rregullt. Vagonat e amllit duhet te kene ne gjendje pune te gjitha paisjet e frenimit qe jane parashikuar ne konstruksionin e uzines prodhuese.

Neni 137

Vagonat e udhetaresh duhet te kene doreze per frenin e sigurimit te vendosur brenda dhe te plumbosur, pervec vagonit te plackave.

Neni 138

Te gjitha pjeset e sistemit te frenimit, zgjidhja ose renia e te cilave mund te shkaktoje dalje jashte permasave ose renie ne vijen hekurudhore, duhet te kene paisjet e sigurimit.

P J E S A E T R E T E ORGANIZIMI I LEVIZJES SE TRENAVE

Kapitulli I

Dispozita te Pergjithshme

Neni 139

Organizimi i levisjes se trenave ka per qellim kryerjen e rregullt te transportit te udhetaresh dhe te mallrave, duke ruajtur sigurimin e plote te levizjes se trenave dhe te punes se manovres, duke shfrytezuar ne menyre racionale mjetet hekurudhore, fuqine punetore, si dhe materialet e paisjet e tjera hekurudhore.

Neni 140

Baza e organizimit te levizjes se trenave eshte grafiku i levizjes i cili lidh punen e te gjitha njesive hekurudhoreper kryerjen e planit te transportit.

Levizja e trenave sipas grafikut do te thote nisje ne kohe e trenave nga stacionet, udhetim sipas kohes se percaktuar ne grafik ne vijen hekurudhore dhe arritje ne kohe ne stacion, gje qe sigurohet me nje organizim te mire te procesit tekniko-logjik te punes ne stacionet, ne parkun e mjeteve hekurudhore dhe ne njesite e tjera te hekurudhes qe marin pjese ne levizjen e trenave.

Qendra e shfrytezimit

Neni 141

Qendrat e shfrytezimit te hekurudhave ndahen ne postet e levizjes dhe ne qendrat e sherbimit te udhetaresh dhe te mallrave.

Neni 142

Postet e levizjes sherbejne per drejtimin e sigurte dhe te rregullt te levizjes se trenave. Ato duhet te kene pajisjet e nevojeshme teknike.

Postet e levizjes ndahen ne poste kryesore, ne poste te vijave industriale dhe te degezimeve.

Neni 143

Post kryesor eshte ai qe cakton rradhen e kalimit te trenave. Ne postet kryesore bejne pjese stacionet.

Neni 144

Kufirin ne mes posteve kryesore (stacionet) dhe vijes hekurudhore e percaktojne shenjdhesisit e hyrjes se ketyre posteve, ose tabelat e paralajmerimit, aty ku mungojne shenjdhesisit.

Neni 145

Stacion quhet ai post kryesor, ne te cilen vija baze kryesore degezohet te pakten me nje vije kryesore shtese, ku trenat mund te fillojne ose mbarojne udhetimin e tyre, te kryqezohen, te kalojne njeri tjetrin si dhe te nderrojne perberjen dhe drejtimin e tyre.

Stacionet kane vendet e posacme per hipjen dhe zbritjen e udhetareve, si dhe vendet per ngarkim-shkarkimin e mallrave.

Neni 146

Sipas karakterit te transportit dallojme stacione udhetarësh, stacione mallrash dhe stacione te perziera mallra udhetare.

Detyra e stacioneve te udhetareve eshte sherbimi i levizjes se udhetareve, dergimi i plackave dhe i postes.

Detyre e stacionit te mallrave eshte sherbimi i transportimit te mallrave dhe kryerja e veprimeve te lidhura me kete, si dhe sherbimi i ndermarjeve industriale, porteve, uzinave, minierave etj.

Nga pikpamja e vendosjes se stacionit ne vije hekurudhore dallojme stacione fundore, stacione nyje dhe stacione te ndermjetme.

Stacioni fundor eshte vendosur ne fillim ose ne fund te vijes hekurudhore.

Stacion nyje eshte ai ne te cilen mbildhen dy ose me shume vija hekurudhore, nga drejtime te ndryshme.

Stacionet ndermjetese jane vendosur ne vijen hekurudhore midis dy stacioneve nyje me te aferta, ose midis stacionit fundor nga njera ane dhe stacionit nyja nga ana tjetere, ose njri mbas tjetrit.

Neni 147

Posat degezimi hekurudhor quhet posti i vendosur prane degezimit te vijes hekurudhore ose prane degezimit te vijave industriale.

Neni 148

Postet hekurudhore prane vijave industriale qe kane per detyre tu sherbejne atyre, jane postet qe marrin vetem ne pranimin ose ne nisjen e trenave ne sherbim te ketyre vijave industriale.

Neni 149

Ne vijen hekurudhore mund te vendosen mund te vendosen pika sherbimi te caktuara per nisjen e udhetareve ose per veprime ngarkim-shkarkimi.

Pika sherbimi quhen qendresat e udhetareve, vendet e ngarkim shkarkimit dhe postet e tjera prane vijave industriale.

Neni 150

Vendi i qendrimit të udhetareve është pika e shërbimit të vendosur në vijën hekurudhore, e caktuar për hipjen dhe zbritjen e udhetareve. Kjo pikë mund të vendoset dhe pranë postit të degezimit të vijës industriale, pranë postit të mbrojtjes, si dhe stacionet e mbyllura për nevojat teknike të hekurudhës.

Neni 151

Vendi i ngarkim-shkarkimit është pikë shërbimi të vendosur në vijën hekurudhore për ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave që lejohet vetëm në raste të veçanta duke përcaktuar të gjitha masat e nevojshme për sigurinë edhe vazhdueshmerinë e levizjes së trenave.

Neni 152

Sipas urdherit të ministrit nr 885 datë 31.03.1988 ky nen hiqet komplet.

Neni 153

Në stacionet hekurudhore vendosen poste teknike ku bëjnë pjesë posti I ndërruesit etj.

Neni 154

Posti i ndërruesit është ai post teknik që u shërben ndërruesve të stacionit ose një pjesë të tij.

Neni 155

Cdo post levizje, vend qendrimi i udhetareve, vendi i ngarkim shkarkimit si dhe cdo post teknik, duhet të ketë emrin e caktuar.

Emri i cdo posti vendoset në godinën e tij si nga balli edhe nga të dy anët e mbërritjes së trenave, në vende që duken qartë nga treni.

Vijat hekurudhore, ndarja dhe numri i tyre

Neni 156

Vijat hekurudhore I ndajme në vija kryesore (perigone) dhe në vija të stacioneve. Në stacion dallojme këto vija.

- a. Kryesorja – baza, që është zgjatimi i perigonit dhe shërben për kalimin e trenave.
- b. Kryesorja – shtese, e cila degezohet nga vija kryesore-baze dhe që shërben për kalimin e trenave me shpejtësi të zvogëluar.
- c. Anesoret janë vijat e tjera të stacionit, të cilat nuk shërbejnë për pranimin-nisjen e trenave, këto vija në varësi të qëllimit të tyre marrin emra si psh. Te magazines, të ngarkim-shkarkimit, të qendrimit, të riparimit të vagonave etj.
- ç. Vija për qëllime të veçanta, siç janë vijat mbrojtëse.

Neni 157

Në vijat hekurudhore me një vijë, vija kryesore baze përcaktohet me numrin 1. Vijat që gjenden në anën e djathtë të vijës kryesore baze në drejtim të rritjes së kilometrazhit, marrin numrat tek si psh. 3,5,7,9 ndërsa vijat që gjenden në anën e majtë të vijës kryesore baze, në drejtim të rritjes së kilometrazhit marrin numrat çift si 2,4,6,8 etj.

Për rastet e stacioneve njëje dhe të vijave kryesore baze marrin numrat I, II

Në stacionet e mëdha mund të zbatohet numerimi me grupe shifra dhjetëshe ose qindëshe.

Neni 158

Vijat mbrojtese hekurudhore jane ato vija qe kane per qellim mbrojtjen e perigonit dhe te postit te levizjes, ose per sigurimin e rruges se kalimit. Ato duhet te kene nje gjatesi jo me te vogel se 50m nga shtegu.

Neni 159

Te gjitha vijat hekurudhore brenda kufijve te stacionit, eme perjashtim te atyre qe jane ne dispozicion te plote te ndermarjeve te tjera, gjenden nen administraten e drejtorive rajonale dhe te stacioneve hekurudhore.

Neni 160

Ne cdo post te levizjes duhet te gjendet plani skematik i tij ne shkallen 1/1000

Nderrueset dhe sherbimi i tyre

Neni 161

Nderrueset numerohen me numra rendore nga njeri skajs i postit te levizjes ne tjetrin, ne drejtim te rritjes se kilometrazhit.

Nderrueset e parashikuara ne projektin e zgjerimit te stacionit, perfshihen ne numrin e pergjithshem.

Neni 162

Nderrueset dhe nxjeresit nga shinat, normalisht duhet te ndodhen ne pozicionin e parashikuar i cili tregohet ne dokumentin teknik te stacionit. Ky pozicion siguron levizjen e trenave dhe te mjeteve hekurudhore.

Nderrueset dhe nxjereset nga shinat mund te zhvendosen nga pozicioni i parashikuarne dokumentin teknik te stacionit ne rastet e meposhteme.

- a. Kur pergatitet rruga e kalimit te trenit per nisje-pranim
- b. Gjate kryerjes se manovres ne stacion
- c. Ne rastet e domosdoshme per sigurimin e mjeteve hekurudhore qe qendrojne ne vijen hekurudhore: per ndalimin e vagonave te rreshqitura nga perigoni, si dhe gjate kontrollit, pastrimit e riparimit te tyre.

Neni 163

Ne dokumentin teknik te stacionit caktohen se cilat nderruese dhe nxjerrje nga shinat duhet te jene te sigurta.

Neni 164

Te gjitha nderrueset duhet te jene ne gjendje te rregullt teknike dhe kur dukshmeria eshte e kufizuar, te jene te ndricuar.

Neni 165

Nderrueset dhe nxjereset nga shinat perdoren vetem nga punonjesit e caktuar kur ndodhen ne sherbim, te cilet jane te pajisur me deshmi aftesie per kete pune.

Mbajtja ne rregull dhe paster e nderruesve eshte detyre e nderruesit ose e punonjesve te caktuar vecanerisht per kete pune. Ne stacionet e vegjel ku nukka nderrues, kjo detyre i takon inspektorit te sherbimit.

Neni 166

Nderrueset e vendosura ne perigon i jepen nen mbikqyrje njerit prej stacioneve fqinje. Keto mund te perdoren ose jo nga nderruesa te perhereshem sipas percaktimit te bere nga drejtoria e hekurudhes me udhezim te vecante.

Celesat e nderruesve te vijave hekurudhore industriale dhe te degezimeve qe nuk sherbehen nga nderruesit ne vend, ruhen tek inspektori i sherbimit i ngarkuar per to.

Neni 167

Para fillii te riparimit te nderrueses nga brigada e mirembajtjes, nderruesi duhet te kontrolloje vendosjen e rregullt te sinjaleve mbrojtese. Mbas mbarimit te riparimit, nderruesi duhet te bindet per qenien ne rregull te nderrueses dhe ndryshonb shenimin e mepareshem ne librin e caktuar per kete qellim.

Ndricimi i terrenit dhe i godinave te stacionit

Neni 168

Ne dokumentin teknik te stacionit caktohen se cilat vende dhe lokale te stacionit , si dhe ne cfare menyre duhen ndricuar.

Ndricimi i stacioneve dhe i terrenit te punes duhet te behet ne menyre te mjaftueshme, qe te siguroje levizjen e trenave dhe te punes se manovres, sigurimin e sherbimit te udhetareve, kryerjen e rregullt dhe te sigurt te punes, si dhe mbrojtjen e pasurise hekurudhore dhe te mallrave.

Ndricimi i jashtem nuk duhet te pengoje shikimin e shenjave ose te shformoje kuptimin e tyre.

Oret e sherbimit

Neni 169

Ne zyrat e sherbimit te levizjes se trenave, si dhe ne godinat e stacioneve kryesore duhet te kete ore sherbimi. Oret e jashteme te sherbimit ne kohe te erret duhet te jene te ndricuara.

Oret e sherbimit duhet te kontrollohen per sakesine e tyre dy here ne dite sipas ores ekzakte, te dhene nga dispeceri I levizjes I drejtorise se hekurudhes.

Neni 170

Te gjitha lokotivat e transportit duhet te jene te paisura me ore sherbimi te cilat kontrollohen me oret e sherbimit te stacionit prej mashinistit dy here ne dite.

KAPITULLI II

Perdorimi i shenjave

Neni 171

Cdo punonjes i hekurudhes duhet te njohe dhe te zbatoje ne praktike shenjen e ndalimit te trenit dhe te d ije se ne cfare rrethanash duhet te zbatoje ate.

Cdo punonjes i hekurudhes, puna e te cilit eshte e lidhur me levijen e trenave, duhet te njohe me hollesi rregulloren e shenjezimit.

Neni 172

Shanjat “ndal” te cilat urdherojne ndalimin e trenit dhe te mjeteve jane:

- a. Drita e kuqe e shenjehenesve dhe e paisjeve te tjera te shenjezimit
- b. Ngjyra e kuqe e tabelave te levizeshme
- c. Pershkrimi i nje rrethi ne planin vertikal me vijen hekurudhore me anen e flamurit, fenerit ose te ndonje sendi te cfaredoshem, si dhe me dore.
- ç. 3 tinguj te shkurter te dhene me sirene ose me bilbil dhe te perseritur disa here.
- d. Plasja e 3 pedarteve
- dh. Shiriti i ri horizontal ne diskun e vijes qorre
- e. Shenja e fillii ose e fundit te trenit.

Mungesa e drites ne shenjdhene si ditën, ashtu dhe naten, si dhe tregimi i pakuptueshem dhe jo i rregullt i shenjave ne shenjdhene dhe ne tabelat e paralajmerimit, kerkojne ndalimin e menjehereshem te trenit ose te mieti hekurudhor.

Neni 173

Shenja “ndal” qe urdheron ndalimin e trenit zbatohet

- a. Per mbrojtjen e posteve te levizjes dhe te perigonit
- b. Pre mbrojtjen e treni tose te mjeteve ndihmese te ndaluara ne perigon
- c. Gjate kryerjes se punes se manovres
- ç. Per mbrojtjen e fundit te trenit
- d. Ne te gjitha rastet kur rrezikohet levizja e trenave dhe jeta e njerezve.

Neni 174

Ndalohet kalimi prej trenit i shenjdhene qe tregon shenje “ndal”

Neni 175

Shenjta e zvogelimit te shpejtesise jane.

- a. Nje drite me ngjyre te verdhe ne parashenjen elektrike dhe ne shenjdhene qe hyrjes dhe te daljes nga stacioni
- b. Ngjyra e verdhe ne tabelat e paralajmerimit te palevizshem ose te levizshem, qe sherbejne per zvogelimin e shpejtesise se levizjes se trenit.

Neni 176

Shenja e zvogelimit te shpejtesise zbatohet: per pranimin e trenit ne vije kryesore qe kerkon zvogelimin e shpejtesise, si dhe nisjen e trenave nga vijat kryesore qe kerkojne zvogelimin e shpejtesise.

KAPITULLI III

Grafiku i Levizjes Se Trenave

Neni 177

Grafiku i levizjes se trenave te udhetareve hartohet nga drejtoria e hekurudhes miratohet nga ministria e komunikacioneve. Drejtoria e hekurudhes miraton grafikun e levizjes se trenave te mallit dhe ka te drejte te anulloje ose te shtoje tren malli ne grafik.

Neni 178

Njekohesisht, me grafikun e levizjes se trenave caktohet grafiku i kthimit te lokomotivave, plani i formimit dhe i kontrollit teknik te trenave dhe i levizjes se tyre. Gjithashtu caktohen dhe turnet e brigadave te trenit, duke pasur parasysh ekonomizimin sa me racional te mjeteve dhe brigadave.

Neni 179

Grafiku i levizjes se trenave duhet te hartohet ne menyre te tille qe te siguroje.

- Transportimin e shpejte ekonomik dhe te rregullte te udhetareve dhe te mallrave
- Kalimin e sigurte te trenave ne perigone dhe ne stacione e degezime
- Shpejtesine e nevojeshme te levizjes se trenave.
- Shfrytezimin racional te mjeteve hekurudhore dhe te lokomotivave
- Bashkerendimin e punes ne proceset e ngarkim-shkarkimit te vagonave, manovrimit dhe formimit te trenave, levizjes se tyre si brenda territorit te drejtorise rajonale e stacionit hekurudhor, ashtu dhe ndermjet tyre.

Neni 180

Cdo punonjes I hekurudhes, puna e te cilit eshte e lidhur me levizjen e trenave, duhet te punoje ne menyre te tille qe te beje te mundur mbylljen e plote te ciklit te levizjes se trenit ne perputhje me grafikun e levizjes duke ruajtur sigurimin e levizjes se trenave.

Neni 181

Kushtet teknike te levizjes ne vijen hekurudhore dhe ne stacione, qe sherbejne si baze per zbatimin e grafikut te levizjes se trenave caktohen nga drejtoria e hekurudhes dhe perfshijne

- Planin e levizjesse trenave
- Rradhen e vendosjes se vagonave ne trena
- Kontrollin teknik te trenit para nisjes
- Stacionet qe do te meren me pastrimin e trenave
- Stacionet e nderrimit te drejtimit te trenave dhe te nderrimit te lokomotivave e te brigadave te tyre qe u sherbejne trenave
- Rregullin e vendosjes (grupimit) te vagonave dhe kontrollin teknik te trenit para nisjes.
- Precaktimin e trenave te drejteperdrejte.

Neni 182

Drejtorite rajonale apo stacionet hekurudhore bejne zberthimin e grafikut kryesor te levizjes se trenave duke hartuar grafikun e levizjes rajonale te trenave.

Neni 183

Orari i levizjes se trenave te udhetareve botohet ne shtyp dhe vendoset ne cdo stacion udhetarësh.

Neni 184

Cdo tren qe leviz ne hekurudhe emertohet me numrin e tij sipas kitij rregulli
Trenat qe udhetojne ne drejtim te rritjes se kilometrazhit te vijes hekurudhore emertohen me numra tek, ndersa trenat qe udhetojne ne drejtim te kundert emertohen me numra cift. Numrat e trenave duhet te vendosen te tille qe te kuptohet lloji i tyre.

Neni 185

Sipas karakterit te levizjes trenat ndahen ne.

1. Trena te perhereshem, te parashkuar ne grafik dhe qe qarkullojne cdo dite.
2. Trena te perkoheshem ku bejone pjese trena te jashtezakonshem te parashkuar ne grafik dhe qe levizin ne raste nevojte te jashtezakonshme.

Neni 186

Sipas llojit te transportit, trenat ndahen ne trena udhetarësh, malli, te perzier, ushtarak dhe sherbimi. Me tren te perzier do te kuptojme trenat e udhetareve, te cileve u shtohen vagona malli. Ne grupin e trenave te sherbimit bejne pjese trenst ndihmes, trenat bosh qe levizin per ne postet e riparimit, lokomotivat e vecanta, si dhe drezinat e renda me motorr.

Neni 187

Perparesi u jepet trenave ndihmes te cielt dergohen ne raste aksidenti ose avarie qe kane shkatuar nderprerjen e levizjes se trenave. Gjithashtu me perparesine e trenave te ndihmes ne rast nevojte mund te nisen lokomotiva pa vagona, drezina dhe trena te tjere.

Nga pikepamja e rradhes se nisjes duhen konsideruar te pare trenat e udhetareve pas tyre trenat ushtarake dhe trenat me mallra qe pirshen shpejt dhe pastaj trenat me mallra te tjera.

Ne rast crregullimi te grafikut te levizjes se trenave, dispeceria e drejtorise se hekurudhes percakton radhen e levizjes se trenave.

Neni 188

Te drejten per anulimin ose shtimin e trenave te udhetareve e ka ministria e komunikacioneve.

Neni 189

Dispeceri i levizjes se trenva organizon levizjen e trenave dhe pergjigjet per zbatimin sa me te rregullt te grafikut te levizjes brenda kushteve teknike te percaktuara ne kete rregullore, si dhe ne udhezime te vecanta.

KAPITULLI IV

Dispozita te pergjitheshme per sigurimin teknik te levizjes

Neni 190

Levizja e trenave dhe e mjeteve hekurudhore drejtohet vetem nga punonjesit e pajisur me deshmine perkatese te aftesise.

Neni 191

Per cdo post levizje pergatitet dokumenti i tij prej drejtorise rajonale apo stacionit hekurudhor qe e ka ne varesi ate post. Per cdo rast dokumentacioni teknik miratohet nga dega e shfrytezimit ne drejtorine e hekurudhes.

Neni 192

Pasijeve te sigurimit te levizjes se trenave u sherbejne vetem punonjesit me deshmine perkatese dhe vetem kur ata jane ne kohen e sherbimit.

Neni 193

Ndalohet hyrja per personat e paautorizuar ne zyrat e punes se personelit te levizjes se trenave

Neni 194

Ne cdo kohe, ne perigon, ne kushte normale duhet te jete vetem nje tren
Shkelja e ketij parimi lejohet vetem kur per arsye aksidenti ose avarie ne perigon kerkohet ndihma e trenit, e lokomotives apo drezines dhe meren te gjitha masat e kujdesise per sigurimin e plote te levizjes se trenave.

Neni 195

Trenat pranohen ne stacione ne vijat hekurudhore kryesore baze ose kryesore shtese dhe vetem atehere kur rruget e kalimit ne stacion te jene te pergatitura ne rregull dhe vijat hekurudhore te jene te lira. Ne rast te kushteve te jashtezakonshme, dispecerias e drejtorise se hekurudhes mund te lejoje pritjen e trenave ne vijat hekurudhore anesore te stacionit.

Neni 196

Kthimi mbrapa i trenit nga perigoni per ne postin e levizjes nga i cili eshte nisur, mund te kryhet vetem atehere kur eshte mare leje me pare nga inspektorit te sherbimit te ketij posti. Vetem ne rast kur trenit i kercenohet ndonje rrezik i shpejte, mund te behet kthimi mbrapa edhe pa lejen e inspektorit te sherbimit. Ne te dy rastet, trenin qe kthehet mbrapa e shoqeron brigada e tenit me shenja ne krye te tij.

Neni 197

Ne rast te nderprerjes se plote te nderlidhjes midis stacioneve fqinje, levizja e trenave kryehet ne baze te marreveshjes me shkrim te lidhur me stacionin qe nis trenat ne drejtim te ritjes se kilometrazhit si te privilegjuar.

Neni 198

Ne stacionet fundore dhe ne stacione te tjera te caktuara, trenat duhet te kontrollohen nga ana teknike dhe tu kryhet prova e frenave.

Neni 199

Ndalohen rreptesisht: paraqitja ne sherbim ne gjendje fizike dhe mendore jo te rregullt (i dehur, shume i lodhur) dhe kryerja e sherbimit ne kete gjendje, si dhe perdorimi i pijeve alkoolike dhe fjetja gjate sherbimit.
Shkelja e kerkesave te ketij neni ngarkon me pergjegjesi drejtuesit e qendrave te punes, si dhe personat shkaktare.

KAPITULLI V

Puna teknike e stacionit

Neni 200

Puna teknike e stacionit perfshin:

1. Drejtimin e levizjes se trenave, pranimin, nisjen dhe kalimin e trenave
2. Perpunimin e trenave dhe te vagoneve, manovren lidhur me formimin e trenave, vendosjen e vagonave, kontrollin teknik te vagonave, proven e frenave etj.

Neni 201

Sipas urdherit te ministrit nr 855 dt. 31.03.1988 behet
Puna teknike e stacionit duhet te kryhet ne perputhje me rregullsat teknike ne fuqi duke zbatuar dokumentin teknik te stacionit.

Neni 202

Organizimin e punes teknike te stacionit e ben inspektori i sherbimit.

Neni 203

Organizimin e levizjes se trenave ne rajon e ben dispeceria rajonale.

KAPITULLI VI

Manovrimi

Neni 204

Manover quhen te gjitha levizjet e mjeteve hekurudhoresi dhe veprimet qe kryhen ne linjat hekurudhore te lidhura me manovren, me perjashtim te levizjes se trenave qe hyjne, dalin ose kalojne ne stacion.

Neni 205

Sipas urdberit te ministrit nr 885. Dt 31.03.1988 behet

Manovra kryhet me lokomotivat e manovrave ose me lokomotivat e trenit. Ajo mund te kryhet dhe me ane te mjeteve te jashtme me motor, me arganello, me forcen e njerezve, te kafsheve ose me forcen e erendzeses. Brigada e manovres duhet te perbehet nga pergjegjesi i manovres (kryemanovristi) e brigada e lokomotives dhe te pakten nga nje manovrist. Detyren e brigades se

manovres mund ta kryeje edhe personeli I trenit, kur e permban dokumenti teknik i stacionit, ku detyren e pergjegjesit te manovres e kryen kryetari i trenit. Ne raste te vecanta kur drejtuesi i manovres ose manovristi e kryen punen e manovres me nje person atehere atij duhet ti lejohet te hedhe vagonat, si dhe te lidhe dhe ti zgjidhe ato kur jane ne levizje.

Neni 206

Gjate kohes se manovres brigada e lokomotives duhet te gjendet ne lokomotive me perberje te plote, kurse ne kohen qe lokomotiva nuk kryen pune ajo duhet te jete e mbikqyrur, te pakten nga njeri prej personelit te saj. Brigada e lokomotives qe kryen manovren duhet te njohe mire dokumentin teknik te stacionit dhe gjate kryerjes se manovres ka per detyre.

- a. Te veshtroje me kujdes shenjatat dhe ti zbatoje ato ne menyre te sakte.
- b. Te veshtroje me kujdes pozicionin e nderruesve dhe shprendarjen e mjeteve hekurudhore ne vijat hekurudhore te stacionit.

Neni 207

Cdo manover kryhet vetem me “plan manovre”. Planin e manovres e harton inspektori i sherbimit (i jashtem kur ka stacioni) dhe firmoset prej tij. Para se te dorezoje planin e manovres ai ka per detyre te udhezaje pergjegjesin e manovres me hollesi per menyren e kryerjes se detyres.

Plani i manovres duhet te siguroje

- a. Formimin e rregullt dhe ne afat te trenit per nisjen e tij sipas planit te parashikuar ne grafikun e levizjes.
- b. Sherbimin e rregullt dhe ne afat te qendrave te ngarkim-shkarkimit, te riparimit, te pastrimit dhe te larjes se vagonave.
- c. Shfrytezimin e plote te lokomotivave te manovres, si dhe te gjitha mjeteve te tjera dhe te pajisjeve teknike qe sigurojne dhe ndihmojne ne kryerjen sa me te rregullt te manovres.
- ç. Pranimin dhe nisjen e sigurt dhe sipas planit te parashikuar ne grafik te trenave ne stacion.
- d. Sigurimin e punonjesve te manovres dhe te punonjesve te tjere si dhe te mjeteve hekurudhore dhe jo hekurudhore dhe te ngarkeses se tyre.

Kryerja e rregullt e punes se manovres mbikqyret nga inspektoret e sherbimit te stacionit.

Neni 208

Punen e manovres e drejton pergjegjesi i manovres, i cili para se te filloje ate ka per detyre.

- a. Te mare planin e manovres me shkrim dhe te firmosur nga inspektori i sherbimit, i jashtem ose i brendeshem dhe te njihet hollesisht me te.
- b. Te bindet per sigurine e zbatimit te ketij plani.
- c. Ta njohe planin e punes se manovres brigaden e manovres dhe personelin qe merr pjese ne te.

Neni 209

Pa lejen e pergjegjesit te manovres nuk lejohet te behet asnje levizje e mjeteve hekurudhore.

Urdheri per kryerjen e levizjes se manovres jepet vetem me ndihmen e shenjave ne fuqi.

Para dhenies se shenjës, drejtuesi I manovres duhet te bindet personalisht se nuk ka pengesa qe rrezikojne levizjen e mjeteve ose punonjesve te tjere te stacionit.

Urdherat e dhena me ane te shenjave nga drejtuesi i manovres, jane te detyrueshme per makinistin dhe per ndihmesin e tij dhe duhet te zbatohen prej tyre ne rast se keto nuk rrezikojne sigurimin e levizjes ose te njerezve.

Si rregull shenjatat jepen nga ana e makinistit por ne raste te jashtezakonshme mund te jepen edhe nga ndihmesi. Ne keto raste ky i fundit komunikon me makinistin per te gjitha shenjatat e dhena.

Neni 210

Manovrat ne vijen hekurudhore te stacionit mund te behen me pelqimin e inspektorit te sherbimit te brendeshem, vetem mbasi ky I fundit te kete vendosur shenjehenesin perkates me shenjen “ndal” ne vijat kryesore te stacionit.

Manovrat ne vijen kryesore te stacionit ku do te mberrije ose kaloje treni, duhen ndreprere dhe vija hekurudhore te lirohet ne nje kohe te atille kur shenja e lejimit per hyrjen e trenit ne stacion jepet ne castin kur balli i trenit gjendet ne largesi 1000 m nga parashenja ose disku i paralajmerimit. Per nderprerjen e manovres ne kohen e duhur pergjigjet inspektori i sherbimit te brendeshem. Ne dokumentin teknik te stacionit percaktohet koha kur, para hyrjes se trenit duhet ndaluar manovra. Per nderhyrjen e manovres inspektori i sherbimit duhet te njoftoje te gjithë punonjesit qe marin pjese ne te.

Neni 211

Ndalohet kalimi i trenave manovrues jashte kufirit te monovres dhe atje ku kufiri nuk eshte jashte nderrueses se hyrjes, pa u marre vesh me stacionet fqinje.

Neni 212

Ndalohet lidhja dhe zgjidhja e mjeteve hekurudhore gjate manovres nga shkallet e vagonit. Lidhja dhe zgjidhja e mjeteve hekurudhore gjate manovres duhet te kryhet me kujdes te vecante dhe vetem atehere kur ato te kene shpejtesine jo me te madhe sse 3 km/ore. Shenja per levizjen manovruese lejohet te jepet vetem atehere kur punonjesit qe kane kryer lidhje apo zgjidhjen, te kene dale nga pjesa e poshteme e vagonit. Kalimi ipersonave neper vijen hekurudhore, prane mjeteve hekurudhore ne manovrim eshte i ndaluar.

Neni 213

Afrimi i mjeteve hekurudhore per tu lidhur me njeri – tjetrin duhet te behet me kujdes te vecante ne menyre qe te sigurohet nje lidhje e parrezikshme per njerezit dhe mallrat. Shpejtesia maksimale gjate afrimit te lidhjes duhet te jete deri ne 3km/ore.

Gjate manovrimit te vagonave me njerez, kafshe me ngarkesa te rrezikshme (sipas shenjave perkatese) te vagonave te renda mbi 100 ton, te vagonave me mallra qe kalojne permasen dhe te vagonave me bylyko ose te lidhur me vete mallin, brigade e manovres duhet te kete kujdes te vecante dhe per manovrimin e tyre duhet te paralajmeroje personat qe gjenden ne vagona. Per keto vagona ndalohet manovra me hedhje.

Neni 214

Vagonat e ngarkuar me mallra te rrezikshme, gjate manovres duhet te jene te ndare nga lokomotiva diesel te pakten me dy vagona bosh ose te ngarkuar me mall jo te rrezikshem dhe nga lokomotivat e avullit me 12 boshte.

Neni 215

Manovren e kryen brigade e manovres, pergjegjesi i se ciles drejton punen e pjesetareve te tjere dhe eshte i detyruar.

- a. Te siguroje shprendarjen e personelit dhe harmonizimin e punes se tyre.
- b. Te siguroje zbatimin e shpejte dhe me perpikmeri te urdherave dhe te detyrave qe jepen gjate kohes se manovres
- c. Te organizoje punen ne menyre qe te menjanoje cdo demtim ne mjete dhe te siguroje mbrojtjen e personelit te manovres, si dhe te personave te tjere we mund te rrezikohen prej saj.

Neni 216

Ne vijat hekurudhore te stacioneve me pjerresi me te madhe se 2.5 per mije mund te manvrohet vetem me ane te vendosjes duke qene lokomotiva nga ana e pjerresise. Ne rast kur nuk ka mundesi te behet nje vendosje e tille e lokomotives, mund te behet manover vetem nqs vagonat e trenit te kene sasine e nevojeshme te frenave te dores qe do te sherbenin nga brigada e manovres ose te lidhen me sistemin e frenimit automatik duke bere me pare proven e veprimit te frenave. Ne dokumentin teknik te stacionit shenohen vijat, ne te cilat nuk lejohet hedhja e vagonave.

Neni 217

Shpejtesia e levizjes ne manovrim nuk duhet te kaloje.

1. 25 km/ore gjate levizjes se trenit manovrues apo te lokomotivave te manovres ne nderruese dhe ne vija te lira hekurudhore.
2. 15 km/ore gjate levizjes se trenit manovrues apo te lokomotivave te manovres, kur keto hyjne ne nderruese dhe ne vijat hekurudhore te zena.
3. 5 km/ore gjate kryerjes se manovres me vagona me njerez ose mallra te rrezikshme
4. Shpejtesia e kryerjes se manovres ne port dhe ne zona industriale percaktohet ne dokumentin teknik te stacionit.

Neni 218

Nderrueset ne rajonet ku behen manovrat, duhet te binden ne se vagonat kalojne shtegun dhe nese jane te siguruar nga rreshqitja. Detyra e sigurimit (nga rreshqitja) te vagonave qe gienden ne territorin e ndermarjeve te tjera (jo hekurudhore) u takon punonjesve te ketyre ndermarjeve.

Neni 219

Sipas urdherit te ministrit nr 885 dt. 31.03.1988 behet.

Udhezime me te hollesishme qe i perkasin punes se manovres jepen ne rregullat e vecanta te nxjerra nga drejtoria e pergjithshme e hekurudhes.

KAPITULLI VII

Kushtet teknike te formimit te trenit

Dispozita te pergjithshme

Neni 220

Tren quhet grupi I vagonave me nje ose me shume lokomotiva, i paisur me shenjate perkatese, qe sherbehet prej brigades se trenit I pergatitur per udhetim dhe qe ka numrin e tij. Trena konsiderohen dhe vagonat me motor, drezinat, si dhe lokomotivat e vecanta.

Neni 221

Treni duhet te jete i formuar duke u mbeshtetur ne keto dokumente: rregullorja e levizjes, plani i formimit te trenave, grafiku i levizjes se trenave, si dhe udhezimi per zbatimin praktik te tij.

Neni 222

Sipas urdherit te ministrit nr. 885 dt 31.03.1988 behet.

Vagoni I fundit I trenit te udhetareve duhet te kete frena automatike, frena dore, dorezen e frenimit te menjehereshem dhe shenjate e fundit te trenit.

Vagoni I caktuar per shoqeruesin e trenit te mallit me frena automatike ne veprim duhet te kete gsbinen e frenimit, frena automatike, frena dore, dorezen e frenimit te menjehereshem si dhe shenjate e fundit te trenit.

Vagoni i fundit i trenit te mallit me frena automatike ne veprim panvaresisht nga sistemi i ganximit duhet te kete nje shenje te fundit si ditën dhe natën.

Pesha dhe gjatesia e trenit

Neni 223

Sipas urdherit te ministrit nr. 885 dt. 31.03.1988 behet.

Pesha e trenit llogaritet nga shuma e peshes vetjake ne cdo vagon dhe ngarkesen e tyre. Pesha e lokomotives qe terheq nuk llogaritet.

Neni 224

Gjatesia e trenit caktohet ne baze te gjatesise faktike te cdo vagoni qe lidhet me te. Ne gjatesine e trenit duhet shtuar dhe gjatesia e lokomotives terheqese.

Gjatesia e trenit nuk duhet te kaloje gjatesine e dobishme te vijave hekurudhore te pranimit-nisjes per cdo stacion ku ai leviz. Ne raste te jashtezakonshme mund te formohen trena me te gjate se gjatesia e dobishme e vijave hekurudhore dhe ne keto raste levizja e tyre behet ne baze te nje udhezimi te vecante te leshuar prej drejtorit te hekurudhes.

Kushtet teknike te lidhjes se vagonave ne trena

Neni 225

Ndalohet lidhja ne trena:

1. E vagonave permasat e te cileve ose permasat e ngarkeses se tyre kalojne permasat e mjeteve hekurudhore.
2. E vagonave me demtime dhe mungesa ne nyjet kryesore, te cilat rrezikojne sigurimin e levizjes.
3. E vagonave te mallrave te ngarkuara mbi kapacitetin e tyre ose te ngarkuara ne kundersizim me rregullat e ngarkimit.
4. E vagonave qe nuk kane qofte edhe ne jren nga shenjat e percaktuara ne kete rregullore. (neni 124)
5. E vagonave qe kane pesuar dalje nga shinat osse avari pa u kontrolluar gjendja e tyre.
6. E vagonave te cileve u ka kaluar afati i riparimit, me perjashtim te atyre qe dergohen bosh per riparim ne oficine

Vagonat me mungesat e mesiperme duhet te levizin me trena te vecante dhe te shoqeruar me personelin perkates.

Neni 226

Ndalohet lidhja me trenat e udhetareve.

1. E vagonave te ngarkuar me mallra te rrezikshme
2. E vagonave me dy akse me largesi ne mes tyre me te vogla se 3.5 m dhe peshe vetjake me te vogel se 9 ton
3. E vagonave te mallrave, te cileve nga riparimi i fundit u kane kaluar dy vjet.
4. E vagonave me bylyko ose te lidhur me vete mallin.

Neni 227

Me trenat e udhetareve lejohet lidhja e vagonave te mallit qe plotesojne keto kushte.

1. Te jene me frena automatike ne funksion
2. Te kene ne sistemin e frenimit paisjen per vendosjen e rregjimit te frenimit ne pozicionin udhetare.
3. Te mos jene ngarkuar me mallrat e rrezikshme si helme, lende dhe gaze djegese e shperthyes.

Vagonat e zena me kafshe vendosen ne fund te trenit te udhetareve.

Shperndarja e vagonave ne trena

Neni 228

Per qarkullimin e sigurt te trenit shperndarja e vagonave duhet bere si me poshte.

1. Vagonat e rende detyrimisht duhet te vendosen para vagonave te lehte ne pjesen e pare te trenit.

2. Sipas urdherit te ministrit nr. 885 dt. 31.03.1988 behet. Ne vijat hekurudhore me pjerresi 15 o/oo te gjithe vagonat detyrimisht duhet te jene me frenas automatike ne veprim.
3. Grupimi i vagonave ne tren rregullisht duhet te behet sipas sitemit te lidhjes (automatike dhe te zakonsHEME)
4. Vagonat me frena dore ne funksion duhet te shperndahen ne tren ne menyre te njetrajteshme ne sasine qe siguron peshen e nevojeshme te frenimit.

Neni 229

Sipas urdherit te ministrit nr 885 dt. 31.03.1988 ky nen biqet komplet

Neni 230

Trenat e perzier mund te qarkullojne vetem kur jane te paisur me frena automatike. Vagonat e mallrave qe do te lidhen me keto trena duhet te kene paisjen e frenimit ne pozicionet “mallra – udhetare” te vendosur ne pozicionin “udhetare” ne fund te trenit.

Shperndarja e frenave ne trenat e mallrave

Neni 231

Sipas sistemit te frenimit trenat ndahen

- a. Trena me frena automatike, ku hyjne te gjithe trenat qe perbehen prej vagonave me frena automatike.
- b. Trena me frena dore ku hyjne te gjithe trenat qe perbehen teresisht ose ne pjesen me te madhe me vagona me frena dore.

Neni 232

Vagoni me kabine ku qendron kryetari i trenit duhet te gjendet deri ne 12 akse larg lokomotives. Kur ky udheton vetem me nje frene dore ne fund te trenit, kabina e qendrimit do te jete ne fund te trenit. Vagonat me mallra te rrezikshme vendosen te pakten 12 akse larg lokomotives terheqese me avull dhe te pakten 4 akse nga lokomotive me djegje te brendeshme (diesel) dhe larg fundit te trenit deri ne 6 akse.

Neni 233

Vagonat me mallra te rrezikshme duhet te jene shenuar me shenjat e vecanta nga te dy anet. Levizje e vagonave me mallrat e rrezikshme behet ne perputhje me vendimet rregulloren dhe udhezimet ne fuqi, te cilalt drejtoria hekurudhore vazhdimisht ua bent e njohura degeve te drejtorise, qendrave te punes drejtorive rajonale e stacioneve hekurudhore per zbatimin e tyre me perpikmeri.

Neni 234

Ne trenat e mallit me frena dore vagonat me frena shperndahen ne menyre te njetrajteshme ne te gjithe gjatesine e trenit. Frenuesi i fundit duhet te qendroje ne vagonin e fundit te trenit, i cili duhet te kete frena dore ne funksionim.

Vendosje e lokomotivave ne trena

Neni 235

Lokomotivat terheqese vendoen ne krye te trenit.

Lokomotiva mund te vendoset edhe ne fund te trenit ne keto raste.

1. Ne trenat qe kthehen mbrapsht ne stacion
2. Gjate manovres se trenit ne stacion
3. Ne trenat e ndihmens dhe proves

4. Ne trenat qe sherbejne per mirembajtjen e vijes hekurudhore.

Neni 236

Treni mund te terhiqet nga nje ose me shume lokomotiva, por drejtuese eshte lokomotiva e lidhur ne krye te tij. Lokomotivat e tjera mund te vendosen ne fillim, ne mes ose ne fund te trenit. Lokomotivat qe nuk jane ne gjendje pune vendosen mbas lokomotives terheqese.

Lidhja e vagonave

Neni 237

Lidhja dhe zgjidhja e vagonave ne trena eshte detyre e punonjesve qe kryejne manovren Makinisti ne cdo rast eshte pergjegjes per lidhjen e rregullt te lokomotives ne tren. Ne stacionet ku nuk ka manovrist, lidhja dhe zgjidhja e lokomotives i ngarkohet ndihmes makinistit.

Neni 238

Ganxhat e mjeteve hekurudhore qe nuk perdoren per lidhje, duhet te jene te kapura ne menyre te tille qe te mos bien me poshte se 140 mm mbi koken e shines.

Neni 239

Ne trenat e udhetareve lidhja e vagonave dueht te behet e tille qe parapritesit te jene te shtypur njeri me tjetrin kurse ne trenat e mallrave vagonat duhet te lidhen ne menyre te atille qe disqet e parapritesve te takojne ne njeri me tjetrin.

Vagonat e ngarkuara me mallra te rrezikshme duhet te jene lidhur ne grup me ne njeri tjetrin dhe te sigurohen me vagona mbrojtes.

Neni 240

Ndryshimi ne mes lartesis se qendrave te parapritesve te dy vagonave te lidhur me njeri tjetrin nuk duhet te jete me i madh se 125 mm per vagonat e mallrave dhe 85 mm poer vagonat e udhetareve.

Neni 241

Gjate lidhjes automatike eshte e domosdoshme vendosje e sakte dhe sigurimi i spinoteve fiksuese te kokes se lidhjes.

Llogaritja e peshes se frenimit

Neni 242

Frenat e trenave me frena automatike vihen ne veprim nga nje vend dhe veprojne njekohesisht ne te gjitha trenin ndersa ne frenat e dores vihen ne veprim me forcen e krahut dhe cdo frenim kryhet veces.

Ne varesi me kohen e nevojeshme per arritjen e forces se plote te frenimit, dallojme frena me veprim te shpejte dhe frena me veprim te ngadalshem.

Freni i vagonit me fren automatik esht ene veprim atehere kur eshte i lidhur me tubacionin kryesor te trenit.

Force dhe shpejtesia e frenimit te trenave eshte ne varesi me pozicionin e vendosur ne dorezen e valvules trefishe si me poshte.

1. Pozicioni B (bosh) qe vepron ngadale dhe me force te reduktuar
2. Pozicioni P (plot) qe vepron ngadale por me te gjitha forcen
3. Pozicioni U (udhetareve) qe vepron shpejt

Frenat e dores konsiderohen si frena me veprim te ngadalshem.

Neni 243

Ne varesi me pjerresine e rruges ku leviz treni, per te siguruar mos levizjen e tij nga vendi kur demtohet freni automatik, sasia e frenave te dores duhet te jete si me poshte.

Ne vije horizontale dhe ne pjerresi deri ne 5 per mije vagoni i fundit me frena dore te jete i frenuar.

- Nga 5-9 per mije pesha e frenimit 6 %
- Nga 9 – 15 per mije pesha e frenimit 10 %
- Nga 15 – 20 per mije pesha e frenimit 14 %
- Nga 20 – 30 per mije pesha e frenimit 21 %

Ne te gjitha rastet e permendura me sipër lokomotiva duhet te jete e frenuar me frena dore.

Neni 244

Per llogaritjen reale te peshes se frenimit te trenit merret pesha e frenimit te vagonave ne vecanti sipas rregullit te meposhtem.

1. Ne qofte se ne vagon eshte caktuar vlera e peshes se frenimit te tij, atehere per llogaritje merret ajo peshe.

2. Ne rast se vagoni ka vendosje ne pozicione te ndryshme te dorezes se frenit automatik, atehere pas vendosjes se rregullt te dorezes, per llogaritje dueht marre pesha e frenimit e caktuar ne shasine e vagonit ose ne tabelen perkatese.

Ne rast se pesha e frenimit nuk eshte caktuar ne vagon, ajo duhet te merret ne varesi me llojin e frenit si me poshte.

a. Ne frenat automatike

1. Per vagonat e udhetareve me te gjitha akset e frenuara merret pesha e vete vagonit.

2. Per vagonat e mallrave me 4 akse, plot ose bosh, me frenim nga njera ane e rrotave, pavaresisht nga shkalla e ngarkimit, merren 14 ton per vagon, ndersa per vagonat me 2 akse merret gjysma e peshes se vete vagonit.

3. Per te gjitha vagonat me frenim nga te dy anet e rrotave, qe nuk kane doreze per nderrimin e peshes se frenimit merret pesha e vete vagonit.

4. Per vagonat e mallrave qe kane doreze frenimi ne pozicionin “plot” ose “bosh” si shifer qe cakton peshen reale te frenimit merret.

- Per vagonat bosh-pesha e vete vagonit

- Per vagonat plot – 8 ton per cdo aks te frenuar me kusht qe ngarkesa ne bosht te jete me e madhe se 8 ton. Kur ne rast se ngarkesa eshte me e vogel se 8 ton merret vlera e ngarkeses se aksit.

5. Per lokomotivat merret 12 ton per cdo aks.

b. Ne frenat e dores

1. Per vagonat e udhetareve dhe vagonat e mallrave bosh merret pesha e vete vagonit, por jo me teper se 26 ton per vagon.

2. Per vagonat e mallrave te ngarkuar merret pesha bruto e vagonit por jo me teper se 26 ton per vagon.

3. Per vagonat e mallrave me frenim nga njera ane e rrotave merren 14 ton per vagonat me 4 akse dhe gjysma e peshes se vete vagonit per ato me 2 akse

Neni 245

Pesha e nevojeshme e frenimit per cdo tren duhet ti pergjigjet peshes se trenit, shpejtesise se levizjes se tij dhe pjerresise se rruges ku ai leviz dhe caktohet ne baze te tabelave A,B,C ne varesi me rrugen e frenimit.

Pesha reale e frenimit te trenit eshte shuma e peshave te frenimit te vagonave qe kane frena

Neni 246

Rruge frenimi eshte largesia e levizjes se trenit nga fillimi i venies ne veprim te frenit deri ne ndalimin e poote te tij.

Neni 247

Ne cdo tren duhet te jete nje sasi e tille vagonash me frena qe shuma e pergjithshme e peshes se frenimit te tyre te beje te mundur ndalimin e plote te trenit, brenda rruges se frenimit te dhene per cdo tren dhe per cdo vije hekurudhore sipas udhezimit praktik te prcaktuar nga drejtoria e hekurudhes.

Neni 248

Pesha e nevojeshme e frenimit llogaritet ne varesi me peshen e pergjitheshme te trenit dhe me perqindjen e frenimit te dhene ne tabel. Pesha e frenimit e nxjerre nga llogaritja rrumbullakoset duke shtuar deri ne ton te plote.

Neni 249

Kur treni perbehet me frena automatike dhe dore, atehere pasha e frenimit llogaritet vecanerisht per cdo pjese. Ne keto kushte peshes se frenimit me frena dore, ne rast nevoje, mund ti shtohet teprica e peshes se frenimit automatik, por duke siguruar jo me pak se $\frac{3}{4}$ e peshes se nevojeshme te frenimit me frena dore.

Neni 250

Ne rast se pesha reale e frenimit eshte me e vogel se sa kerkohet dhe nuk ka mundesi te plotesohet duke i shtuar vagona me frena, atehere treni mund te niset per udhetim me urdher te dispecerit te levizjes ne drejtorine e hekurudhes, i cili vendos nese do te zvogelohet pesha e trenit apo shpejtesia e levizjes sipas peshes reale te frenimit per pjerrresine maksimale. Ne kete rast inspektori i sherbimit duhet ti jape brigades se trenit urdher te vecante duke I treguar shpejtesine maksimale te lejueshme.

Kontrolli teknik dhe prova e frenave

Neni 251

Formimi i trenit ne stacionin fillestar duhet te perfundoje ne nje kohe qe te behen te mundeshem kontrolli i trenit nga ana teknike dhe prova e frenave, para orarit te nisjes se trenit sipas grafikut. Stacionet e tjera ku behet rikontrolli teknik dhe prova e frenave caktohen prej drejtorise se hekurudhave.

Kontrolli teknik permban: gjendjen teknike te mjeteve hekurudhore, gjendjen e trenave dhe funksionin e rregullt te tyre, shprendarjen e vagonave, ngarkimin dhe lidhjen e rregullt te tyre, sipas rregullave te caktuara.

Neni 252

Kontrollori i vagonave pasi kryen kontrollin teknik te trenit dhe pasi siguron plotesisht gatishmerine teknike te tij, i dorezon makinistit, para nisjes, fleten e kontrollit.

Hollesite e tjera per menyren e kontrollit, dorezimit dhe marjes ne dorezim te trenit jepen ne udhezimin per zbatimin praktik te grafikut te levizjes, qe pergatiten nga drejtoria e hekurudhes. Sipas urdherit te ministrit nr 885 dt. 31.03.1988 ne nenin 252 shtohet ne fund.

Ndalohet nisje e trenit pa u paisur me flete kontrolli.

Neni 253

Kontrolli dhe prova e frenave kryhen:

- Ne trenat me frena dore nga frenuesi qe u sherben atyre.

- Ne trenat me frena automatike nga kontrolli i vagonave ne bashkepunim me brigaden e trenit.

Ne ato stacione ku trenit i shtohen apo u hiqen vagona dhe ku ska kontrollore vagonash kontrollin teknik dhe proven e frenave i kryen makinisti me brigaden e trenit.

Sherbimi dhe paisja e trenave

Neni 254

Brigada e trenit perbehet prej personelit te lokomotives dhe personelit te trenit

Brigada e trenit, gjate qendrimet dhe kohes se punes ne stacion eshte ne varesi te inspektorit te jashtem te sherbimit (ne ato stacione ku nuk ka inspektore te jashtem eshte ne varesi te inspektorit te brendeshem te sherbimit)

Neni 255

Brigada e trenit eshte e detyruar te kryeje levizjet manovruese sipas urdherit te dhene nga inspektori i sherbimit.

Neni 256

Sasia e frenuesve ne trenin e mallrave duhet te jete e tille qe ti pergjigjet perqindjes se frenimit.

Neni 257

Sipas urdherit te ministrit nr 855 dt. 31.03.1988 behet.

Kryetari I trenit ne trenat qe sherbehen vetem prej tij duhet te qendroje ne fundin e trenit, ne vagonin me doreze frenimi, frena automatike dhe frena dore ne veprim.

Neni 258

Cdo frenues apo shoqerues vagoni duhet te sherbeje ne vagonin e caktuar dhe nuk duhet te largohet nga ky vagon pa lejen e kryetarit te trenit.

Neni 259

Sipas urdherit te ministrit nr 885 dt. 31.03.1988 behet

Makinistri kryen detyren e kryetarit te trenit kur treni perbehet prej.

- Locomotives se vetme

- Disa lokomotiva te lidhura me njera tjetren (ne kete rast detyren e kryetarit te trenit e kryen makinisti i lokomotives drejtuese)

- Locomotives terheqese me 20 vagona malli pavaresisht nga sistemi i lidhjes dhe ne pjerresi deri 15 %

- Lokomotives terheqese me 16 vagona malli me te njejtin sistem lidhje me frena automatike ne veprim ne linjat me pjerresi mbi 15 %

- Lokomotives terheqese me 6 vagona udhetaresh bosh.

- Ne qofte se ne keto trena ndodhen vagona te plumbosura, ato shoqerohen prej kryetarit te trenit qe qendron ne lokomotive.

Neni 260

Cdo tren duhet te jete i paisur me mjetet perkatese te shenjezimit, te parashikuara ne rregulloren e shenjezimit dhe te nderlidhjes, te miratuara nag ministria e komunikacioneve.

Brigada e trenit gjate kryerjes se sherbimit duhet te kete mjetet e nevojeshme te shenjezimit te parashikuara ne kete rregullore, ose ne rregulla e udhezime te tjera te leshuara per kete qellim.

Neni 261

Feneret e shenjave te trenit duhet te ndizen ne kohen e duhur prej brigades se tenit dhe per ndricimin dhe vendosjen e rregullt te tyre pergjigjet kryetari i trenit.
Shenjat jane ne inventar ne lokomotives dhe per qenien e tyre ne rregull pergjigjet makinisti.

Neni 262

Lokomotivat dhe vagonat e udhetareve duhet te pajisen me mjetet e mbrojtjes kunder zjarrit.

KAPITULLI VIII

Drejtimi i levizjes se trenave

Dispozita te pergjithshme

Neni 263

Drejtimi dhe levizja e trenave kryhet nga punonjesit e hekurudhes, te pasiur me deshmitet e aftesise perkatese dhe kur jane ne kohen e sherbimit.

Neni 264

Ndalohet nisja e trenave nga stacioni pa "urdher nisje"

Neni 265

Levizja e trenit nga nje stacion ne drejtim te stacionit fqinj behete mbas kryerjes se mareveshjes se dyfishte. Kjo mareveshje kryhet me ane te telefonit, telegrafit, teleshkruesit, bllokimit dhe ne raste te jashtezakonshme ne nderprerjes se tyre me mareveshjen me shkrim

Neni 266

Levizja e trenit ne degezimet hekurudhore kur sherbehet vetem nga nje tren mund te behet pa mareveshje te dyfishte.

Neni 267

Levizjen e trenave e drejtojne dispeceria e levizjes ne drejtorine e hekurudhes dhe dispecerite rajonale hekurudhore, urdherat e te cilave zbaton pa diskutim prej punonjesve te hekurudhes pervec urdherave qe bien ne kundershtrim me RSHT

Neni 268

Leja per nisjen e trenit jepet prej inspektorit te sherbimit te brendeshem te stacionit, pasi te jete siguruar qe perigoni eshte i lire.

Rruga e kalimit te trenit

Neni 269

Me rruge kalimi kuptohet vija hekurudhore, nderrueset dhe nxjerresit nga shinat, te cilete kane lidhje me levizjen e trenit dhe sigurojne kalimin e tij te rregullt dhe pa rreziqe.

Nderrueset dhe nxjerreset nga shinat, qe marrin pjese ne rrugen e kalimit, duhet te mbyllen para kalimit te trenit ne perputhje me tabelen e varesise. Te gjitha paisjet e tjera te sigurimit duhet te jene te vendosura ne menyre te atille qe te sigurojne rrugen e kalimit te lire.

Neni 270

Celesat e nderruesve te mbyllura duhet te vendosen ne tabelat e varesise qe gjenden ne zyren e inspektorit te sherbimit ose te nderruesit.

Neni 271

Kur nderrueset dhe nxjerrset nga shinat per arsye te ndryshme nuk mund te mbyllen, atehere gjate kalimit te trenit ato duhet te ruhen nga nderruesi ose nga nje person tjetër i caktuar nga inspektori i sherbimit.

Kur per arsye te ndryshme nderrueset dhe nxjerrset nga shinat nuk shenjezojne ose nuk lejojne nxjerrjen e celesit nga brava mekanike, ne stacionet qe kane paisjet e shenjezim, centralizim, bllokimit per pergatitjen e rruges se kalimit do te veprohet sipas rregullores se levisjes se trenave.

Neni 272

Pergatitjen e rruges se kalimit te trenit e urdheron inspektori i sherbimit te brendeshem personalisht me anen e telefonit, duke e pasqyruar ate ne librin perkatese.

Punojesit qe marin pjese ne pergatitjen e rruges se kalimit duhet qe ne varesi te paisjeve ekzistuese te verifikojne dhe te sigurohen se.

- Rruga e kalimit nuk ka pengesa per trenin.
- Nderrueset dhe nxjerrset nga shinat jane te vendosura ne rregull.
- Gjilperat e nderruesve te vendosura per rrugen e kelimit puthiten si duhet me shinat baze.

Neni 273

Punonjesi i cili mer urdher per pergatitjen e rruges se kalimit duhet te perserise ate fjale per fjale, me qellim qe te tregojë se e ak puktuar drejt.

Urdheri per pergatitjen e rruges se kalimit, njoftimi per qenien e saj gati, si dhe njoftimi per mberritjen dhe kalimin e trenit duhet te shenohen ne nje liber te vecante. Perjashtim behete ne rastet e pergatitjes dhe verifikimit te rruges se kalimit ne menyre elektrike.

Nisja e trenave

Neni 274

Kusht per nisjen e trenit ne perigon ne varesi me menyren e caktuar per levizjen e trenva eshte.

1. Marja e njoftimit nga stacioni fqinje per mberritjen e trenit te nisur me pare dhe marja e lejes per nisjen se tij.
2. Ne rastin e nderprerjes se plote te nderlidhjes levizja e trenit behet ne baze te mareveshjes me shkrim ne mes te dy stacioneve.

Neni 275

Sipas urdherit te ministrit nr. 3447/1 dt. 22.09.2003 shtohet neni 275/1 i cili

Per nisjen e trenave ne rastet e nderprerjes se plote te nderlidhjes ndermjet postit te inspektorit te sherbimit me postet teknike qe kane vartesi, si postet e nderruesve, postet e kalesave te ruajtura etj. Njoftimiet per pergatitjen dhe sigurimin e rruges se kalimit te trenave kryhen sipas nje udhezimi te vecante te hartuar nga drejtoria e pergjitheshme e hekurudhave me inspektoriatin hekurudhore. Kalimi I trenit nga stacioni ne perigon behet vetem me lejen e inspektorit te brendeshem te ketij stacioni.

Inspektori i sherbimit para nisjes se trenit duhet te sigurohet nese vija hekurudhore deri ne stacionin fqinje eshte e lire dhe nese rruga e kalimit ne stacion eshte e vendosur si duhet dhe e siguruar, dhe nuk ka pengese per udhetimin e trenit ne perigon.

Inspektori i sherbimit duhet te lajmeroje per nisjen e trenit te gjithë punonjesit qe kane te bejne me levizjen e tij, duke i pasqyruar ato ne librat perkatese.

Neni 276

Sipas urdherit te ministrit nr 885 dt. 31.03.1988 pika 1 behet:

1. Gjate marjes se trenit ne dorezim per nisje te kontrolloje dhe te bindet personalisht se:
 - a. Treni eshte formuar ne perputhje me rregullat per shperndarjen e vagonave, i lidhur dhe i paisur me shenjat e duhura.
 - b. Malli eshte i ngarkuar sipas rregullave dhe i siguruar nga cdo demtim ose humbje.
 - c. Personeli i trenit eshte i plote dhe i afte per te kryer detyren.
 - ç. Eshte kryer kontrolli teknik dhe prova e frenave.
2. Te kujdeset qe treni te mos niset pa lejen e rregullt dhe te sakte, te nenshkruaj lejen e nisjes atje ku mungojne shenjedhenesit, duke vene ne dijeni per cdo gje makinistin qe drejton lokomotiven, si dhe te kujdeset per nisjen e trenit ne kohen e caktuar ne grafik.
3. Gjate udhetimit te shikojte shenjat e dhena dhe te kujdeset per levizjen e sigurt te trenit.
4. Te ushtroje vemendje te vecante per ngarkesat dhe sigurimin e mallrave ne vagonat e hapura dhe kur ato nuk u pergjigjen kushteve te permasave, tiheqe nga treni.

Neni 277

Leja per nisjen e trenit nga stacioni ne perigon jepet

1. Me vendosjen e shenjes ne shenjedhenesin e dalijes ne pozicionin “ruge e lire” ne raste te vecanta sherben dhena ne shenjedhenesin e daljes se shenjes rezerve ose e shenjes se manovres: per te dy rastet e fundit brigada e trenit paiset me urdher te vecante ku tregohet arsyea e perdorimit te shenjes rezerve ose e asaj te manovres per daljen e trenit ne perogon, duke bere dhe rregjistrimin ne librin perkates mbi shmangiet nga rregulli me shenjen “rruge e lire” te shenjedhenesit perkates.
2. Ne mungese te shenjedhenesit te daljes, plotesohet leje nisjeje rregullisht nga inspektori i brendeshem i sherbimit dhe nenshkruar prej tij e nga kryetari i trenit.

Neni 278

Ne stacioniet qe bejne formimet dhe perpunimet e trenave, inspektori i jashtem i sherbimit dhe atje ku nuk ka te tille i brendeshmi para nisjes se trenit duhet te kerkoje

1. Vendosjen e vagonave sipas rregullave ne tren
2. Vendosjen e vagonave me frena dore sipas kesaj rregulloreje
3. Paisjen e trenit dhe te brigades se tij me shenjat perkatese
4. Gjendjen e peshes se frenimit te kerkuar dhe atij faktik, gjithashtu kryerjen e kontrollit teknik dhe te proves se frenave.

Ne stacionet ndermjetese ku frenave u shtohen vagona, inspektori i sherbimit duhet te dorezoje kryetarit te trenit “pasqyren e vagonave te shtuar ne tren” kurse kur nuk lihen vagona ne stacion, kryetari i trenit duhet te dorezoje inspektorit te sherbimit ose personit te ngarkuar “pasqyren e vagonave qe hiqen nga treni” se bashku me dokumentet perkatese.

Neni 279

Kur treni kalon pa shenja gundi ose ne kohe te erret me fenere te fikur, inspektori i sherbimit duhet te marre masa per ndalimin e tij dhe te mos nise e te pranoje tjetere tren nga stacioni fqinje, pa vertetuar me pare se treni ka mberritur i plote.

Pranimi i trenave

Neni 280

Pranimi i trenave ne stacion kryehet vetem ne vijen hekurudhore te lire nga mjetet dhe pengesat e tjera.

Ndalohet vendosja e shenjdhënesit të hyrjes në pozicionin “rruge e lire” pa u vertetuar me parë se nuk ka pengesa për hyrjen e trenit dhe për qenien gati të rruges së kalimit.

Neni 281

Ndalohet pranimit i trenit me shenjen “ndal” të vendosur në shenjdhënesit të hyrjes. Në raste të jashtëzakonshme, të përcaktuara me rregulloren e levizjes së trenave, lejohet pranimit i trenave me shenjen “ndal” në shenjdhënesin e hyrjes.

Neni 282

Kur treni ndalon për shenjdhënesit për mungesë dukshmerie, lejohet të vazhdojë udhëtimin vetëm pasi kryetari i trenit dhe makinisti të bindet plotësisht se shenja e shenjdhënesit lejon udhëtimin. Trenat që nuk kanë ndalim në stacion duhet të kalojnë nëpër vijat hekurudhore kryesore të bazeve. Në rast nevojë mund të kalohet në vijën kryesore shtesë të shënuar në dokumentin teknik të stacionit me kusht që :

1. Paisjet e sigurimit të lejojnë kalimin e trenave nëpër vijën kryesore shtesë.
2. Shenjdhënesi i hyrjes të tregojë shenjen “rruge e lire” me shpejtesë të kufizuar.

Kur treni ndalon për shenjdhënesit të hyrjes të pa ndricuar me shenjen përkatëse, lejohet të vazhdojë udhëtimin, vetëm pasi në shenjdhënesin e hyrjes jepet shenja rezervë me dritë të bardhë që ndizet e shuhet. Në këto raste hyrja në stacion bëhet me kujdes të veçantë dhe me shpejtesë jo më të madhe se 15 km/ore.

Neni 283

Trenat e udhëtareve mund të pranohen vetëm në vijat hekurudhore të caktuara në dokumentin teknik të stacionit.

Në rast nevojë të justifikuar inspektori I brendshëm I shërbimit, për trenin e udhëtareve mund të ndryshojë vijën hekurudhore të hyrjes të parashikuar në dokumentin teknik në vijën tjetër kryesore.

Neni 284

Ndalohet zënia e vijave kryesore hekurudhore dhe e vijave qorre mbrojtëse me vagona dhe mjete të tjera hekurudhore.

Neni 285

Në raste të jashtëzakonshme lejohet të pranohet treni në vijën hekurudhore të stacionit pjesërisht të zënë.

Në këtë rast treni duhet të ndalojë për shenjdhënesit të hyrjes dhe pas kësaj të vazhdojë udhëtimin me shpejtesë që nuk i kalon 15 km/ore në zbatim të shenjës rezervë në shenjdhënes.

Në vendin ku duhet të ndalojë treni në stacion duhet të jepet shenja “ndal” në dorë.

Neni 286

Shenjen në shenjdhënesin e hyrjes që lejon hyrjen e trenave në stacion, e vendos personalisht inspektori i brendshëm i shërbimit.

Shenja e dhënë në shenjdhënes që lejon hyrjen e trenave në stacion jepet për çdo tren në veçanti.

Neni 287

Shenja “rruge e lire” në shenjdhënesin e hyrjes duhet të jepet në një kohë të atillë që të mos shkaktojë ndalimin e trenit për shenjdhënesit ose të ulët shpejtesia e levizjes.

Neni 288

Në stacionet që nuk janë të përshtatshëm për pranimin e menjëherëshëm të dy trenave nga drejtime të ndryshme duhet që njëri prej tyre të ndalojë për shenjdhënesit të hyrjes.

Ne stacion futet zakonisht treni, kushtet e ndalimit te te cilit para shenjdhesisit te hyrjes dhe levizja e tij nga vendi jane te veshtira.

Perparesia e pranimit te trenave ne varesi me kushtet teknike te stacionit duhet te jepet ne dokumentin teknik te tij.

Neni 289

Inspektori i jashtem i sherbimit duhet te prese cdo tren qe hyn ose kalon ne stacion.

Ne stacionet ku nuk ka inspektor te jashtem, kete detyre e kryen inspektori I brendeshem.

Neni 290

Per trenat qe kalojne pa ndalimin ne stacion ne shenjdhesisin e hyrjes shenja “rruge e lire” duhet te jepet vetem atehere kur dalja nga stacioni eshte e lire.

Ne keto raste inspektori i jashtem i sherbimit duhet te prese trenat ne peron dhe te jape shenje me dore.

Trenat e mallrave lejohet te kalojne pa ndalim ne stacionet e caktuara ne grafikun e levizjes per ndalimin, vetem atehere kur ky ndalim nuk eshte i nevojshem.

Neni 291

Treni qe hyn ne stacion duhet te ndaloje ne vendin e caktuar ne kufijte ne mes te shtigjeve dhe para shenjdhesisit te daljes qe tregon shenjen “ndal”

Per ndalimin e trenit ne kufijte e shtigjeve te kontrollit jane pergjegjes : inspektori i sherbimit, kryetari i trenit, frenuesi i fundit dhe nderruesi. Ne rast se eshte e pamundur vendosja e rregullt e trenit qe nuk futet brenda kufijve te dhtigjeve te kontrollit, frenuesi i fundit duhet ta mbroje ate me sjena nga ana e vijave hekurudhore fqinje ne perputhje me rregullren e shenjzimit.

Nderruesi ne rajonin e te cilit ka ndaluar treni, duhet te verifikojte shtigjet e kontrollit dhe te bindet nese shtegu i kontrollit te zene eshte i mbrojtur ne baze te rregullave.

Ndalimi i kohes se trenit para shtegut te shenjdhesisit te daljes, qe tregon shenjen “ndal” eshte detyre e personelit te lokomotives.

Neni 292

Pas hyrjes, kur i gjithë treni ka kaluar nderruesen e pare te hyrjes dhe pasi eshte vertetuar qe ka mberritur me shenjat e fundit, shenjdhesis vendoset ne pozicionin normal.

Neni 293

Ne rast se shihet ndonje pengese qe rrezikon hyrjen e trenit shenja ne shenjdhesis “rruge e lire” duhet te ndryshohet menjehere me shenjen “ndal”

Neni 294

Inspektori i sherbimit verifikon personalisht mberritjen e trenit ose kete verifikim e bene ne baze te lajmerimit me ane te telefonit nga ana e nderruesit dhe shenohet ne dokumentet e levizjes si nga ana e nderruesit, ashtu dhe nga inspektori i sherbimit.

Neni 295

Ne stacionet fqinje te vijes hekurudhore, ku jane vendosur paisjet e shenjezim- centralizim – bllokimit dhe ne stacionet ku keto paisje mungojne, nisja e trenave behete ne baze te lejes me shkrim, si dhe duke hapur shenjen “rruge e lire” ne shenjdhesisin e daljes.

Hyrja e trenit ne keto stacione behet ne baze te lejes me shkrim per qenien e lire te perigonit dhe me hapjen e shenjes “rruge e lire” ne shenjdhesisin e hyrjes.

Neni 296

Ndalimi i trenit para shenjdhënesit të hyrjes është i domosdoshëm në këto raste.

1. Kur pranohet treni i mallrave ose lokomitva pa vagona në vijën hekurudhore të stacionit të zënë.
2. Kur ndodh shkeputja e varesisë së ndërrueses me shenjdhënesin e hyrjes ose në rrethana të tjera që kërkojnë ndalimin e trenit, për të cilat brigada e trenit nuk ka qenë e njoftuar me parë.

Për kohën që nuk do të ketë shenjdhënes, shenjat zevendesohen me lejen me shkrim për nisjen e trenit.

Nisja e trenave para kohe

Neni 297

Treni i udhëtarëve nuk lejohet të nisët në asnjë rast nga stacioni me shpejtësi është parashikuar në grafikun e levizjes së trenave: gjithashtu nuk lejohet kalimi i tij pa ndalim në stacionin e parashikuar për ndalim në grafikun e levizjes së trenave.

Në stacionet ku sipas grafikut të levizjes, nuk parashikohet ndalimi, trenat e udhëtarëve mund të kalojnë para kohës së dhënë në grafikun e levizjes jo më shumë se 3 min.

Neni 298

Trenat e mallrave, si rregull duhet të nisen sipas kohës së përcaktuar në grafikun e levizjes së trenave. Treni i mallit në rastin kur nisja me e shpejtë e tij mund të shkaktojë vonesën e trenave të tjera, nuk lejohet të nisët para kohës së caktuar në grafikun e levizjes.

Inspektoret e shërbimit duhet të ndjekin levizjen e trenave dhe të merren vesh me stacionet e tjera në rast nevojë me dispecerine e levizjes, me qëllim që levizja e tyre të bëhet sipas grafikut.

Organizimi dhe drejtimi i levizjes së trenave në kushtet e përdorimit të paisjeve elektrike dhe në rastet e mosfunksionimit të pjesëshëm ose të plote të paisjeve të sigurimit të trenave

Neni 299

Mbajtja në gadishmeri të plote të paisjeve të sigurimit të levizjes së trenave është detyrë kryesore jo vetëm e punonjësve që meren drejtpërdrejt me montimin, ndreqjen dhe shërbimin e tyre, por dhe për të gjithë punonjësit e tjera që kanë lidhje me levizjen e trenave.

Mosveprimi në rregull i paisjeve të sigurimit të levizjes së trenave ndikon jo vetëm në uljen e shkalles së sigurimit të levizjes por edhe në uljen e kapacitetit lëshues e përpunues të stacioneve që mund të sjellë si pasoje çrregullime të theksuara në punën e levizjes në përgjithësi. Prandaj çdo e mëtej sado e vogël, në këto paisje duhet menjëherë. Megjithatë për të bërë të mundur levizjen e pandërprerë të trenave dhe punën e manovrës edhe në kushtet e mosveprimit të paisjeve të sigurimit të levizjes, inspektoret e shërbimit të brendshëm dhe të jashtëm veprojnë sipas rregullave të mëposhtme.

1. Hapja e vijave hekurudhore të stacionit dhe kalimi i trenave bëhet vetëm nën mbikqyrjen e inspektorit të shërbimit të brendshëm nga zyra e komandimit.
2. Nisja e trenave bëhet vetëm në baze të shënjes që jep kryetari i trenit, mbas hapjes së shenjdhënesit përkatës, që si rregull nuk hapet me shpejtësi se 2 min para nisjes së trenit.
3. Përgjegjës për të gjithë levizjen në territorin e stacionit dhe për kryerjen e saj në rregull është inspektori i shërbimit të brendshëm.
4. Inspektori i brendshëm dhe ndërruesi përgjigjen për rajonin e tyre, për qenien e lirë të vijave hekurudhore në stacion gjatë pranimit të trenit.
5. Inspektori i brendshëm i shërbimit duhet të ketë lidhje telefonike me stacionet fqinje, me postet e ndërruesve dhe të kalësve si dhe me dispecerine e levizjes në drejtorinë e hekurudhës, nga e cila varet për problemin në lidhje me levizjen e trenave. Gjithashtu duhet të ketë lidhje telefonike me

dispecerite rajonale, inspektorin e jashtem per bashkerendimin e punes, lidhur me levizjen e trenave dhe punen e manovres.

6. E gjithë levizja manovruese deri nekufirin e manovres behet nen drejtimin e kryemanovristit, nen mbikqyrjen e inspektorit te sherbimit te jashtem dhe me lejen e inspektorit te brendeshem. Kalimi i kufirit te manovres behet vetem me lejen me shkrim te dhene nga inspektori i brendeshem i sherbimit.

7. Kontrolli teknik i punes lidhur me formimin dhe shperndarjen e trenave, nisjen e tyre ne orar dhe ne rregull si dhe organizimi ne pergjithesi i punes se manovres kryhet nga inspektori i jashtem, i cili per levizjen varet nga inspektori i brendeshem: keshtu inspektori I jashtem drejton ne menyre operative te gjithë punen me trena dhe manovren ne stacion dhe mban pergjegjesi per kryerjen e sakte dhe te rregullt te saj.

Inspektori i jashtem pas mbarimit te punes se manovres eshte i detyruar te njoftoje inspektorin e brendshem se cilat vija hekurudhore te stacionit jane te zena me mjetet hekurudhore.

Neni 300

Ne stacionet ku ka vetem nje inspektor te levizjes, detyrat e inspektorit te brendeshem dhe te jashtem i kryen inspektori i levizjes se stacionit.

Neni 301

Ne rast mosfunktionimi te bllokades se vijes hekurudhore, levizje e trenave behet ne baze te marreveshjes telefonike me shkrim ndermjet dy stacioneve fqinje. Ne kete rast pergjegjesia per plotesimin e sakte te lejeve te nisjes bie mbi inspektorin e brendeshem. Dorezimi i kesaj lejeje kryetarit te trenit behete nepermjet inspektorit te brendeshem ose atij te jashtem.

Po keshtu veprohet edhe per plotesimin dhe dorezimin e urdherave te vecanta. Urdheri i vecante perdoret ne te gjitha rastet e parashikuara ne kete rregullore, me perjashtim te ndalimit te trenit para shenjdhenesit te hyrjes, per arsye te futjes se tij ne vijen pjeserisht te zene (gje per te cilen vlen dhenia e shenjes rrezerve ne shenjdhenesin e hyrjes)

Neni 302

Kur treni niset nga stacioni me shenje rezerve, ne kushtet kur bllokada e vijes hekurudhore punon ne rregull, nisja e tij nga stacioni behet me urdher te vecante te plotesuar ne 3 kopje.

Neni 303

Ne rastin e mosfunktionimit te zhvendosjes elektrike te nderruesve ose te varesise se tyre elektromekanike, zhvendojs e tyre behet me dore.

Ne kete rast inspektori i sherbimit eshte i detyruar te beje kontrollin ne vend per zhvendosjen e nderrueses ne pozicionin e kerkuar, verifikimin e pergatitjes se rregullt te rruges se kalimit.

Neni 304

Punimi dhe pastrimi i nderruesve, si dhe perdorimi i tyre me dore behet gjithmone me lejen e inspektorit te brendeshem dhe pasi te jete menjanuar mundesia e zhvendosjes se tyre elektrike.

Neni 305

Udhezime te hollesishme mbi perdorimin e pasijeve te sigurimit te levizjes se trenave, ne rastet e veprimit te tyre te plote, te pjeseshem ose ne rastet e mospveprimit, jepen ne instruksion te vecante nga drejtoria e hekurudhes.

Shpejtesia e trenave

Neni 306

Shpejtesia maksimale e lejueshme e trenave varet nga:

1. Konstruksioni i lokomotives
 2. Konstruksioni dhe gjendja e vagonave
 3. Lloji i frenave dhe pesha reale e frenimit
 4. Sistemi dhe gjendja e tabanit tokesor dhe e shtreses se sipërme te vijes hekurudhore, e nderruesve e paisjeve te meirembajtjes dhe e paisjeve te sigurimit te levizjes trenave
- Shpejtesia maksimale e lejueshme e trenave, qe nuk mund te kalohet, mbi nderruese jepet ne udhezim praktik te levizjes se trenave ne drejtim dhe ne kthese.

Neni 307

Shpejtesia e trenave duhet te kufizohet edhe ne rastet e meposhtem.

1. Kur treni udheton me frena dore, deri ne 45 km/ore
2. Kur treni me frena automatike me nje lokomotive terheqese ne kryes shtyhet.
 - a. Me nje lokomotive deri ne 45 km /ore
 - b. Me dy lokomotiva deri ne 30 km/ore
3. Kur treni shtyhet pa lokomotive terheqese deri ne 30 km/ore dhe ne rast se kalesat jane te pambrojtura deri ne 15 km/ore
4. Ne hyrje te stacionit per trenat e mallrave ose te lokomotives pa vagona, ne vijen hekurudhore pjeserisht te zene deri ne 15 km/ore gjithashtu gjate kalimit neper vendet e mbrojtura me shenja "ulje shpejtesie" ne rast se nuk eshte caktuar shpejtesia deri ne 30 km/ore
5. Gjate kalimit te trenit ne vendin e rrizkshem me ane te shoqeruesit deri ne 5 km/ore.
6. Ne kthim mbrapa te trenit, ne marreveshje me stacionin deri ne 15 km/ore
7. Ne kthimin e trenit mbrapa, pa mareveshje, deri ne 5 km/ore
8. Ne te gjitha rastet kur treni udheton i shtytur, detyrimisht ne kreun e tij duhet te shoqerohet me nje punojes te pasitur me shenja.

Kufizimet e shpejtesise te permendura me lart jane te detyrueshme per te gjitha rastet.

Neni 308

Drejtoria e hekurudhes duhet te jape kufizimet plotesuese perkatese, kur kete e kerkon gjendja e vijes hekurudhore, e nderruesve dhe e paisjeve te sigurimit.

Ne rastet kur kerkohet kujdes i posacem, drejtoria e hekurudhes lejon kalimin e trenit me ane te shoqeruesit ne vendet e caktuara te perigonit. Levizja me shoqerues konsiston ne kete, qe cdo tren duhet te ndaloje prane vendit te caktuar per marjen ne lokomotive te shoqeruesit dhe te vazhdoje udhelimin sipas shenjave qe i jep shoqeruesi.

Veprimet e brigades se trenit gjate kohes se udhetimit

Neni 309

Para nisjes se trenit makinisti duhet te shikojte dhe kontrolloje gjendjen e veprimin e rregullt te te gjitha mekanizmave dhe te pasijeve, vecanerisht funksionimin e pasijeve te frenimit, te furnizimit, te derdhjes se reres, si dhe te sirenes dhe te gjitha aparateve matese te lokomotives, kurse ndihmes makinisti duhet te vajise me saktesi te gjitha pjeset levizese te lokomotives. Gjithashtu makinisti duhet te kontrolloje formimin e trenit, si dhe gjendjen e shenjave te tij.

Brigada e lokomotives duhet te kujdeset per udhelimin e digurt, per punimin e lokomotives pa nderprerje dhe te rregullt, gjithashtu per konsumimin me kursim te lendeve djegese, te vajrave dhe te energjise elektrike.

Neni 310

Ne hyrje dhe ne dalje te vijave hekurudhore te stacionit, brigada e lokomotives duhet.

1. Te veshetroje dhe te zbatoje me perpikmeri shenjat dhe treguesit, si dhe shenjat e dhena nga punonjesit e stacionit dhe brigada e shoqeruesve.

2. Te veshetroje levizjen e trenave dhe te lokomotivave manovruese ne vijat hekurudhore fqinje dhe te ndaloje me cdo kusht trenin ne rast kur i kercenohet ndonje rrezik.

Neni 311

Para nisjes se trenit makinisti duhet

- a. Te kontrolloje perfundimisht gjendjen e lokomotives.
- b. Te bindet nese lokomotiva eshte e lidhur si duhet me vagonin e pare te trenit
- c. Te bashkeveproje ne kryerjen e kontrollit teknik te proves se frenit, si dhe te verifikojte presionin e ajrit ne rezervuarin kryesor dhe ne tubin kryesor.

Neni 312

Makinistit te lokomotives terheqese nuk i lejohet te largohet nga vendi ne te cilen eshte parashikuar prova e hollesishme e frenave, pa berjen e kesaj prove dhe pa marjen e shenjes se kryetarit te trenit: po keshtudhe makinistit te lokomotives pa vagona dhe ne rastet e tjera kur ai kryen detyren e kryetarit te trenit, nuk i lejohet nisja nga stacioni pa marjen e shenjes nga inspektori i sherbimit.

Neni 313

Ndalohej udhetime ne lokomotive i personave qe nuk bejne pjese ne brigaden e lokomotives, me perjashtim te personave te autorizuar dhe te brigades se trenit kur lokomotiva kthehet pa vagona dhe keta ne numer jo me teper se tre veta. Kjo nuk i perket udhetimeve per prova eksperimentale ose prova te udhetimeve te tjera te vecanta.

Neni 314

Gjate kohes se udhetimeve te trenit, brigades se lokomotives i ndalohej shkeputja e vemendjes nga drejtimi dhe sherbimi i lokomotives. Ajo duhet te veshetroje me kujdes perigonin, shenjat dhe treguesit, si dhe te mbaje vazhdimisht ne gjendje te shtypur ose te terhequr trenin per te menjanuar keputjen e tij.

Neni 315

Gjate udhetimeve ne perigon ndalohej.

1. Kapercimi i shpejtesise maksimale te lejueshme, te caktuar ne grafikun e levizjes per trenin e dhene dhe i shpejtesise se dhene ne paralajmerimet me shkrim, ose te treguar me shenja dhe tregues perkates.
2. Udhetime ne pjerresi me shpejtesi e cila per arsye te peshes se frenimit te trenit ben te pamundur ndalimin e tij ne rrugen e caktuar te frenimit.

Neni 316

Makinisti duhet te respektojte ne perigon kohen e udhetimeve te dhene ne grafik.

Neni 317

Ne drejtim te levizjes se trenit makinisti duhet:

1. Te veshetroje dhe te jape shenjat e caktuara, te mbaje paisjet e frenimit vazhdimisht te pergatitutra per veprim, ti kontrolloje ato, te frenojte dhe te shfrenojte ne kohen e duhur, te ndaloje trenin dhe ta ndaloje ne menyre te rrjedheshme pa perplasje
2. Te kontrolloje me ndihmen e mjeteve shishet qe tregojne niveline ujit ne kazan, duke mos lejuar renien e tij nen nivelin minimal.
3. Te kontrolloje presionin e vajit ne kazan, duke mos lejuar kalimin e vijes se kontrollit te manometrit:te kontrolloje presionin e ajrit dhe te vajit, temperaturen e vajit dhe te ujit e te tjera

4. Te perdore frenimin e menjehereshem, vetem ne raste te domosdoshme
5. Te mos lejoje renien dhe rritjen e presionit ne rezervuaret dhe ne tubin kryesor te frenimit mbi kufijte eparashikuar per tipin e dhene te mieti dhe frenimit.
6. Ne rast defektesh te frenave automatike ose te kompressionit te ajrit, te ndaloje menjehere ttrainin dhe te njoofte brigaden shoqeruese per udehtimin me frena dore dhe per domosdoshmerine e frenimit ne pjerresi.

Udhetimi deri ne stacionin me te afert mund te beheet me shpejtesine qe i pergjigjet sasise se frenave te dores ne funksion

Ne rast se pesha e frenimit ne fakt eshte me e vogel sesa kerkohe, udhetimi deri ne stacionin me te afert mund te kryhet ne pjerresi deri ne 10 per mije me shpejtesi jo me te madhe se 10 km/ore kurse ne pjerresi me te madhe se 10 per mije me shpejtesi jo me te madhe se 5 km/ore. Udhetimi i metejshe me frena dore mund te kryhet me miratimin e dispecerit te levizjes te drejtorise se hekurudhes.

Neni 318

Gjate kohes se udhetimit te trenit, i ndalohe brigades se locomotives te shkepuse vemendjen nga drejtimi dhe sherbimii locomotives. Makinisti dhe ndihmesi i tij duhet te veshetroje me kujdes perigonin, shenjat dhe treguesit, duke i perseritur nejri pas tjetrit shenjat qe shohin.

Neni 319

Kur i afrohet stacionit ne hyrje, ashtu eshe ne dalje makinisti duhet.

1. Te jape shenjat perkatese
2. Te veshetroje shenjat ne hyrje ose ne dalje dhe sipas tyre te beje levizjen e trenit.
3. Te frenoje siduhet, ne qendrimet e parashikuara ne menyre qe te mos kaloje shenjat qe ndalojne levizjen e metejshe dhe shtigjet.
4. Te veshetroje nese vija e hyrjes eshte e lire.

Ndihmes makinisti duhet ta drejtoje vemendjen gjithashtu ne veshtrimin e shenjave dhe te treguesve, njekohesisht ne verifikimin nese makinisti i respekton ato.

Neni 320

Ne raste te papritura te dhenies se shenjes “ndal” ose kur verghe ndonje pasiguri qe rrezikon trenino se njerezit, makinisti duhet te marre te gjitha masat e mundeshme, ne menyre qe te ndaloje trenin sa me shpejt

Neni 321

Makinisti duhet te mdaloje trenin para shenejdhenesit qe tregon shenjen “ndal”

Ndalohe kapercimi i shenjedhenesit qe tregon shenjen “ndal”

Kryetari i tenit duhet gjithashtu qe ne afrim te stacionit te udhtroje vemendjen ne shejne e diskut te paralajmerimit dhe te shenjedhenesit.

Neni 322

Ne rast dukshmerie te keqe (mjegull, bresher etj) kur treni i afrohet stacionit, makinisti duhet te tregoje vemendje te posacme ne shenjen e parashenjes dhe te rregulloje levizjen e trenit ne menyre qe te kete mundesi te ndaloje trenin patjeter para shenjedhenesit te hyrjes qe tregon shenjen “ndal” ose para ndonje shenje tjeter te ndalimit.

Neni 323

Ne rast se shenjdheneesi qe mbron degezimin ne perigon, tregon shenjen “rruge e lire” per ne drejtim tjeter nga ai per te cilen eshte nisur treni, te merren masat perkatese te mbrojtjes dhe te kerkohen udhezime nga inspektori i sherbimit.

Neni 324

Gjate udhetimit te trenit me dy lokomotiva, levizjen e trenit e drejton makinisti i lokomotives se pare. Makinisti i lokomotives se dyte duhet te zbatoje dhe te punoje ne baze te shenjave te dhena nga makinisti i lokomotives se pare.

Neni 325

Ne rast keputje te trenit me frena dore, duhet qe menjehere te frenohet fort pjesa e keputur dhe te jepet shenja e keputjes se trenit.
Ne rast se vagonat e keputur levizin ne drejtim te trenit, atehere nuk lejohet frenimi i trenit, perderisa nuk ka qene e mundur te ndalohen vagonat.

Neni 326

Ne rast se makinisti i trenit me frena automatike jee shenjen “frenim i forte” brigada e personelit te trenit duhet te veje ne perdorim frenin metani dhe menjehere te frenoje fort.

Neni 327

Duhet menjantuan frenimi teper i forte i cili shkakton rreshqitjen e rrotave mbi shina.
Mbi vendet e demtuara te vijes qe kerkojne uljen e shpejtesise, treni duhet te levize me shpejtesine e dhene dhe me frena te liruara.

Neni 328

Ne cdo rast kur ndalohet treni ne vijat horizontale, freni automatik duhet lira: ne pjerresi duhet te mbetet i frenuar deri ne castin e nisjes.
Ne trenin e frenuar me frena dore, te ndaluar ne vijen horizontale ose ne pjerresi 2.5 per mije duhet te jete ifrenuar vetem vagoni i fundit, kurse ne pjerresi me te madhe se 2.5 per mije duhet te jene te frenuar te gjitha vagonat me frena dore, deri ne castin kur makinisti jep sinjalin “shfrenim i plote”
Ne keputjen e lokomotives ose te nje pjese te trenit qe udheton me frena dore, te gjitha vagonat me frena te pjeses se trenit qe mneten ne vend duhet te jene te frenuar.
Ne rast shkeputje te lokomotivesose ose te nje pjese te trenit qe udheton me frena automatike, makinisti duhet te frenoje te gjitha trenin, para ndarjes se lidhjes se tubave te frenimit. Pervec kesaj ne pjesen e trenit qe mbetet ne vend, duhet te jete i frenuar te pakten nje vagon me frena dore dhe nje pjerresi te madhe te vendosen dhe papucet.

Neni 329

Gjate udhetimit te trenit me locomotive shtytese ndalohen:

1. Makinisti i lokomotives terheqese te nderprese terheqjen perpara se te jape shenjen “shtylla e metejshme eshte e panevojshme”
2. Makinisti i lokomotives terheqese deh shtytese te ndaloje trenin pa dhenien e shenjes perkatese.

Neni 330

Makinisti i locomotives terheqese kur shikon pengesa qe kerkojne ndalimin e trenit duhet te jape menjehere shenjen “frenim I forte” dhe te veproje per ndalimin e trenit, kurse makinisti i lokomotives

shtytese duhet ti perserise menjehere keto shenja dhe te ndaloje gradualisht shtyrjen, ne menyre qe te menjanoje shkeputjen e trenit.

Me perjashtim te ndonje rreziku te papritur, makinisti i lokomotives terheqese duhet te filloje te frenoje dhe te marres te gjitha masat per ndalimin e trenit, vetem pas perseritjes se shenjes “frenim i forte” nga lokomotiva shtytese.

Ne rast se makinisti i lokomotives shtytese veren pengesa, te cilat kerkojne ndalimin e trenit, duhet te jape shenjen “frenim i forte” dhe gradualisht te filloje te mos shtyje, kurse lokomotiva terheqese duhet te perdore te gjitha mjetete mundeshme per ndalimin e trenit.

Neni 331

Makinisti i lokomotives shtytese duhet te zbatoje me perpikmeri shenjat e dhena nga lokomotiva terheqese dhe eshte i detyruar te veshtroje me kujdes trenin. Ne rast se lokomotiva shtytese eshte e lidhur me trenin, duhet ta shtyje trenin vetem ne te perpjete.

Neni 332

Ne rast se lokomotiva shtytese nuk eshte e lidhur me trenin, makinisti i lokomotives shtytese duhet te mbaje ate vazhdimisht te tatua me trenin qe shtyn.

Mbas mbariit te shtyrjes, lokomotiva shtytese duhet te kthehet ne stacionin nga u nis, ne perputhje me rregullat ne fuqi

Neni 333

Ne rast se lokomotiva shtytese nuk eshte lidhur me trenin, makinisti i lokomotives shtytese duhet te mbaje ate vazhdimisht te tatua me trenin qe shtyn.

Mbas mbarimit te shtyrjes, lokomotiva shtytese duhet te kthehet ne stacionin nga u nis, ne perputhjes me rregullat ne fuqi.

Paralajmerimet qe i jepen brigades se trenit

Neni 334

Brigada e tenit paralajmerohet me shkrim nga ana e inspektorit te sherbimit per te gjitha rrethanat e jashtezakonshme, te cilat mund te ndikojne ne rregullsine ose sigurimin e levizjes se trenave.

Neni 335

Te gjitha punimet qe kerkojne kufizimin e shpejtesise se trenave ose rritjen e kujdesit (koha e vazhdimit te te cileve parashikohet te pakten 6 muaj) duhet te parashikohen ne udhezimin mbi zbatimin e grafikut te levizjes se trenave. Per keto raste nuk jepen urdhera te vecanta. Ne rast punimet ne vijen hekurudhore kerkojne zvogelimin e shpejtesise ose nje kujdes te vecante per nje kohe te shkurter, duhet te shenohen en librat e paralajmerimeve ne zyrat e inspektoreve te sherbimit dhe te jepen urdhera te vecanta ne formen e caktuar.

Neni 336

Spektori i mirembajtjes duhet te njoftoje me shkrim ne afatet e caktuara inspektorin e sherbimit te trenave ne te gjitha stacioniet e duhura mbi paralajmerimet e detyrueshme, si dhe mbi anulimin e paralajmerimeve.

Marja njoftim si per uljen e shpejtesise, ashtu dhe per kujdes te vecante ne perigon, duhet te shenohen ne librin e paralajmerimeve.

Ndalimi i trenit ne perigon

Neni 337

Treni duhet te ndaloje ne perigon ne rastet e meposhteme:

1. Perpara shenjes “Ndal”
2. Me rast se veren ne treno se ne vijen hekurudhore ndonje pengese per udhetimin e metejshem, ose kur rrezikohet jeta e njerezve.

Neni 338

Ne raste te domosdoshme per ndalimin e trenit ne perigon makinisti i lokomotives terheqese duhet:

1. Te vere ne veprim frenin automatik ose te jape shenjen per perdorimin e frenave te dores.
2. Ne rast se nuk eshte i domosdoshem frenimi i menjehershem, te ndaloje trenin brenda mundesive ne vije pa pjerresi dhe ne drejtim
3. Menjehere, sebashku me kryetarin e trenit, te sqaroje mundesine per udhetimin e metejshem. Para nisjes ne keto raste te ribeje kontrollin teknik dhe proven e frenave, se bashku me kryetarin e trenit.

Neni 339

Per trenin e ndaluar para shenjdhesisit qe tregon shenjen “ndal” inspektori i sherbimit nuk kerkon mbrojtjen e tij me shenja. Kur brigada e trenit eshte njoftuar per nderprerjen e plote te nderlidhjes ose per rrethana te jashtezakonshme, atehere inspektori i sherbimit kerkon mbrojtjen e trenit. Inspektori i sherbimit qe ka ndaluar trenin para shenjdhesisit te hyrjes duhet te lajmeroje menjehere per kete me telefon, inspektorin e sherbimit te stacionit fqinje nga i cili eshte nisur treni.

Neni 340

Kur kerkohet mbrojtja e trenit, per shkak te crregullimeve ne linjen hekurudhore, makinisti me kerkesen e kryetarit te trenit, duhet te jape shenjen “mbro trenin” me qellim qe te therrase punonjesit e mirembajtjes per menjanimin e ketij crregullimi.

Neni 341

Ne rast se treni pa lokomotive shtytese ka ndaluar ne te perpjete te forte, makinisti duhet qe brenda mundesive, ta ktheje ne nje vend me nje profil me te lehte. Kthimi mbrapa i trenit duhet te jete i mbrojtur ne baze te rregullave.

Neni 342

Treni i ndaluar ne perigon mund te kthehet ne stacion pa qene i mbrojtur me shenja, ne rast se kthimi eshte bere me miratimin e inspektorit tesherbimit te ketij stacioni. Ne rast se kthimi prapa nuk eshte bere me miratim, atehere para trenit qe kthehet duhet te kaloje nje punojes me shenje dore ne nje largesi nga treni te barabbarte me rrugen e frenimit. Ne rast se treni qe kthehet arrin deri ne vendin qe kryetari i trenit mund te merret vesh me stacionin, atehere kthimi i tij behet pa qene nevoja e shoqeruesit qe shkon perpara.

Neni 343

Kthimi mbrapa i trenit ndalohet: ne rastet kur kushtet atmosferike nuk jane te favorshme, kur dukshmeria eshte veshtiresuar dhe kthimi i trenit nuk eshte bere ne marreveshje me inspektorin e sherbimit te stacionit fqinj.

Neni 344

Pas menjanimit te pengeses per vazhdimin e udhetimit, makinisti mund te levize trenin, vetem pas marrjes nga kryetari i trenit te shenjes “nisu”

Neni 345

Ne rast se pas ndalimit te trenit ne perigon, ndodh qe lokomotiva nuk ka mundesi te levize me gjate, atehere kryetari i trenit duhet te lajmeroje sa me shpejt stacionin me te afert dhe te kerkoje ndihme. Ne rast se treni ka ndaluar ne perigon, per shkak te ndonje pengese tjeter gjate 30 min nuk largohet kjo pengese, atehere duhet kerkuar gjithashtu dergimi i ndehmes.

Deri ne kohen e mberritje se ndihmes, nuk lejohet te udhetohe me gjate dhe as te kthehet treni, pa miratimin e stacionit nga i cili eshte kerkuar ndihme. Ne rast se nje pjese e trenit mund te udhetoje me gjate, atehere pjese e perparshme e nisim me shenjat e fundit nen drejtimin e shoqeruesit te caktuar nga kryetari i trenit.

Numrin e vagonit te fundit te kesaj pjese e shenon shoqeruesi i mesiperm, me qellim qe te vertetoje pas mberritjes se trenit ne stacion nese pjese e para ka mberritur e plote.

Pjesa e mbetur e trenit ne perigon duhet te mbikqyret dhe te mbrohet nga te dy anet.

Terheqja e pjeses se trenit te mbetur ne perigon duhet te behet zakonisht nen drejtim e personit qe terheq pjesen e pare.

Neni 346

Per ndalimin e trenit ne perigon zbatimin e masave te kujdesise, dhenien e ndihmes dhe per largimin e trenit nga perigoni, inspektori i sherbimit duhet te njoftoje patjeter dispecerin e levizjes se drejtorise hekurudhore dhe dispecerin rajonal.

Neni 347

Ne rast se mjetet e shenjezimit te lokomotives (sirena) kane pushuar se veoruari, atehere udhetimi i metejshem i trenit duhet te behet duke pasur nje kujdes te vecante. Ne rast se treni udheton me frena dore, makinisti duhet te ndaloje trenin per mosveprimin e sirenes. Udhetimi i metejshem duhet te kryhet me shpejtesi te zvogeluar qe lejon ndalimin e trenit pa pjesmarjen e brigades se shoqeruesve te vagonave. Gjate mjegulles ose furtunes, debores etj, qe veshtiresojne pamjen, ne rast prishjeje te sirens duhet te shkohet deri ne stacionin me te afert me shpejtesi te zvogeluar dhe te kerkohe lokomotiva ndihmese.

Mjetet levizese ndihmese dhe drezinat e renda me motorr

Neni 348

Me fjalen mjete ndihmese levizese duhet te kuptohen mjetet me peshe te veten 750 kg qe jane te perdoreshme per udhetim neper vijat hekurudhore, si dhe mjetet me te renda qe kane paisje per largimin e tyre te shpejte nga vija. Ne cdo mjet ndihmes duhet te gjenden aq njerez sa nevojiten per largimin e tij te shpejte nga vija hekurudhore.

Mjetet ndihmese nuk lejohet te lidhen njera pas tjeters dhe as te lidhen me trenat.

Neni 349

Me fjalen drezine e rende me motorr duhet te kuptojme drezinat dhe vagonat me motorr si dhe makinat e ndertimit me transmission mekanik me pershe te veten 750 kg e me teper dhe qe nuk kane paisje per largimin e tyre te shpejte nga vija hekurudhore.

Drezinat e renda me motorr, nga pikepamja e pranimi te nisjes dhe te udhetimit ne perigon, duhet te trajtohen si trena.

Per dallimin e shpejte nga mjetet ndihmese, drezinat e renda me motorr duhet te jene shenuar me nje shirit te kuq ne krye dhe ne fund te mjetit.

Makinat e ndertimit, si dhe vagonat e punes qe dergohen ne perigon, duhet te trajtohen si trena pune.

Neni 350

Mjetet ndihmese dhe drezinat e renda me motorr perdoren vetem per nevojat zyrtare. Ato mund te qarkullojne zakonisht ne kohe dite, ndersa ne kohe te erret vetem per rastet e domosdoshme

Neni 351

Mjetet ndihmese dhe drezinat e renda me motorr duhet te gjenden vazhdimisht te mbyllura ose te mbikqyrura: pas heqjes se tyre nga vija hekurudhore, ato duhet te vendosen ne ruajtje jashte permasave.

Udhetime te hollesishme mbi qarkullimin e mjeteve ndihmese jepen ne instruksione te vecanta te leshuara nga drejtoria e hekurudhes.

Sherbimi i udhetareve

Neni 352

Te gjitha punonjesit e hekurudhave jane te detyruar qe te jene te gatshem per tu sherbyer udhetareve. Gjithashtu jane te detyruar qe prej tyre te kerkojne mbajtjen dhe zbatimin me perpikmeri te rregullave te percaktuara nga ministra e komunikacioneve.

Neni 353

Sallat per qendrimin e udhetareve duhet te kene rregull dhe pasterti shembullore dhe nje ndricim te mire. Ne keto salla duhet te varet orari i trenave, rregullorja mbi udhetimin ne tren dhe cmimi i biletave.

Personat duhet te mbahen ne gjendje e mire, te paster dhe me ndricim te plote. Udhetaret me ane tabelash duhet te drejtohen per ne trenat perkates.

Neni 354

Punonjesit qe jane ngarkuar per tu sherbyer udhetareve, jane te detyruar qe te sigurojne pa rrezikshmerine ne hypjen dhe ne zbritjen e tyre, si dhe gjate udhetimit te trenit.

Eshte e ndaluar

- a. Te hypin dhe te zbresin udhetaret nga vagonat kur treni eshte ne levizje.
- b. Levizja e qendrimi i udhetareve gjate udhetimit ne urat midis vagonave e neper shkallet kur keto nuk jane te mbourojtura.

Neni 355

Drejtoria e hekurudhes, drejtoret e drejtorive rajonale si dhe shefat e stacioneve kane per detyre.

- a. Te kontrollojne vazhdimisht punen per sherbimin e udhetareve, te ndjekin pastertine dhe mirembajtjen e stacionit dhe te kerkoje nga te gjitha punonjesit qe te plotesojne te gjitha detyrat kundrejt udhetareve.
- b. Te organizoje ne kohe informacionin per udhetaret per mberritjen dhe nisjen e trenave te udhetareve dhe te trenave te tjere.
- c. Te organizoje ne kohe informacionin per udhetaret per mberritjen dhe nisjen e trenave te udhetareve dhe te trenave te tjere.
- ç. Te analizoje cdo dite zbatimin e grafikut te levizjes se trenave te udhetareve.
- d. Te kontrolloje here pas here sherbimin e udhetareve.

Neni 356

Kryetari i trenit ka per detyre te kujdeset qe para nisjes se trenit te kryhet kontrolli teknik i frenave ne stacionet e parashikuara per kete pune.

Shoqeruesi i vagonave ne trenat e udhetareve ka per detyre

- a. Te kujdeset qe vagoni gjate levizjes se trenit te jete me dyer te mbyllura
- b. Te mbaje vagonin te rregullt dhe te paster

c. Te sillet me kujdes me udhetaret dhe te tregohet i gatshem per tu siguruar atyre nje udhetim te kendshem.

ç. E vendos rregull ne hyrjen dhe ne daljen e udhetareve duke qendruar vete prane hyrjes se vagonit per te manjanar cdo konfuzion dhe rrezik per ta.

Neni 357

Per moszbatim te neneve te mesiperme dhe te nenpikave te tyre ndaj demeve qe u shkaktohen udhetareve, pergjigjet personeli perkates.

KAPITULLI IX

Pranimi dhe provimi i punonjesve te transportt hekurudhor

Dispozita te pergjithshme

Neni 358

Cdo punojes perpara se te filloje punen ne trapsortin hekurudhor duhet ti nenshtrohet provimit per te kontrolluar njohurite e tij teorike dhe praktike per:

sipas urdherit te ministrit nr 885 dt 31.03.1988 ne pikat a.b.c.d.e. fjala “rregulloren” behet “rregullat”

a. Rregullat e shfrytezimit teknik te hekurudhes

b. Rregullat e shenjezimit

c. Rregullat e levizjes se trenave

ç. Rregulla mbi manovren

d. Rregullat mbi mirembajtjen e vijes hekurudhore

dh. Udhezimin “detyrat dhe te drejtat e punonjesve te hekurudhes ne levizjen e trenave.

e. Pjese nga kodi penal

é. Cdo rregull dhe udhezimqe ka te beje me detyrat e tij.

Keto prova organizohen periodikisht.

Neni 359

Sipas urdherit te ministrit nr 885 dt 31.03.1988 behet

Provat i organizon drejtoria e pergjithshme e hekurudhave dhe inspektoriati hekurudhor duke zbatuar rregulloren “mbi dhenien dhe heqjen e deshmive te aftesise” leshuar nga ministria e tranporteve

Neni 360

Sipas urdherit te ministrit nr 885 dt 31.03.1988 ky nen hiqet komplet

Neni 361

Cdo punonjes qe kryen me sukses provimet, I jepet deshmia e aftesise

Neni 362

Te gjithë punonjesit e pranuar ne pune dhe qe kane lidhje drejperdrejt me sigurimin e levizjes se trenave, perpara se te filloje nga puna duhet ti nenshtrohen kontrollit mjeksor per te verifikuar nese i lejon gjendja shendetesore qe te kryejne kete pune.

Kontrolle te tilla mjeksore kryhen periodikisht.

Neni 363

Punonjesit me moshe me te re se 18 vjec nuk mund te paisen me deshmi aftesie per levizjen e trenave

Neni 364

Punojesit e hekurudhave jane te detyruar qe gjate punes se tyre te mbrojne pronen qe u besohet.

Neni 365

Punonjesit e hekurudhave nuk duhet te lejojne qe personat e huaj te nderhyjne ne paisjet hekurudhore (lokomotiva, shenja, nderruese, aparate)
Punonjesit e hekurudhes te cilet bejne praktike per tu pergatitur si praktikante, nuk duhet te drejtojne dhe te sherbejne te pa varue ne lokomotive, ne shenja, ne aparate matjeje dhe ne paisje te tjera. Keta mund te drejtojne dhe te punojne vetem nen mbikqyrjen dhe nen pergjegjesine e punonjesit qe sherben drejperdrejt ne ato pasije dhe qe i ka ne ngarkim.

Neni 366

Cdo punonjes i hekurudhes eshte i detyruar qe posa te zbulohen defekte ne shenja, ne vijen hekurudhore dhe ne paisjet e sigurimit teknik te levizjes, te cilat mund te rrezikojne levizjen e trenave, te marre menjehere te gjitha masat e mundeshme qe keto defekte ti menjanoje sa me shpejt duke bere me pare mbojtjen e vendit me shenja.

Neni 367

Cdo punonjes i hekurudhes eshte i detyruar te jape shenjen “ndal” per ndalimin e trenave ose te manovres, gjithmone, kur rrezikohet levizja e trenave dhe jeta e njerezve.

Neni 368

Punonjesit e hekurudhave sipas percaktimit te bere nga ministria e komunikacioneve jane te detyruar te mbajne uniformen ne rregull gjate kryerjes se detyres.

Neni 369

Eshte e ndaluar qe te fillojne punen punonjesit qe nuk jane ne gjendje fizike dhe mendore te mire. Ne qofte se konstatohet, se gjate punes, ndonje punonjes nuk eshte ne gjendje fizike dhe mendore te mire, ai duhet te largohet menjehere nga puna (sherbimi) dhe punen e tij ta kryeje nje tjetër. Punonjesit e hekurudhes qe meren me levizjen e trenave ndalohen te dalin ne sherbim pa deshmi aftesie.

Neni 370

Cdo punonjs qe ben pjese ne levizjen e trenave eshte pergjegjies drejperdrejt per sigurimin e levizjes se trenave ne masen e detyres se tij.

Neni 371

Shkelja e rregullave te shfrytezimit teknik ndihqet sippas shkalles dhe karakterit per masat disiplinore ose penale.